FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 66

Tiranë – E mërkurë, 17 prill 2024

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 31/2024, datë 4.4.2024	Për një ndryshim në ligjin nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.....	7727
Dekret i Presidentit nr. 151, datë 17.4.2024	Për shpallje ligji.....	7727
Vendim i Kuvendit nr. 34/2024, datë 11.4.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 94/2017, "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionerëve Publikë", i ndryshuar.....	7727
Vendim i Kuvendit nr. 35/2024, datë 11.4.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 92/2017,"Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit," i ndryshuar.....	7729
Vendim i Kuvendit nr. 36/2024, datë 11.4.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 93/2017, "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit", i ndryshuar.....	7730
Vendim i Kuvendit nr. 37/2024, datë 11.4.2024	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 98/2014, "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil", i ndryshuar...	7732
Vendim i Kuvendit nr. 38/2024, datë 11.4.2024	Për emërimin e zonjës Mimoza Kaçi, anëtare e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, në funksionin e drejtorit të përgjithshëm ekzekutiv.....	7734
Vendim i Kuvendit nr. 39/2024, datë 11.4.2024	Për zgjedhjen e zonjës Fatjola Delija anëtare të Komisionit të Konkurrencës.....	7734
Vendim i Kuvendit nr. 40/2024, datë 11.4.2024	Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar "Për të koordinuar dhe mbikëqyrur të gjitha veprimet institucionale për të luftuar dezinformimin dhe format e tjera të ndërhyrjes së huaj në proceset demokratike të vendit".....	7734

Vendim i Kuvendit nr. 41/2024, datë 11.4.2024	Për mosdërgimin e mocionit në Gjykatën Kushtetuese.....	7735
Urdhër i ministrit të Financave nr. 40, datë 5.4.2024	Për delegimin e kompetencës për mbikëqyrjen e veprimtarisë administrative të Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera.....	7736
Urdhër i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nr. 120, datë 12.4.2024	Për delegimin e kryerjes së detyrave që kanë të bëjnë me procedurat e prokurimit publik.....	7736
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 278, datë 11.4.2024	Për delegim të përkohshëm kompetencash.....	7737
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 16, datë 12.3.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-3578, datë 7.12.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	7737
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 17, datë 13.3.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 457, datë 21.10.2022, të Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; nr. 171, datë 9.11.2022, të Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; nr. 00-2023-8, datë 12.1.2023, të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	7748
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 21, datë 3.4.2024	Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave për transfertat e kreditit dhe të debitimit direkt në euro.....	7755
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nr. 6785, datë 15.12.2023	Për shpalljen të vdekur të shtetasit Ervin Hasanaj	7761

LIGJ
Nr. 31/2024

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 55/2015, "PËR INVESTIMET STRATEGJIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozim të një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

Neni 1

Në nenin 36, fjalët "data 31 dhjetor 2023" zëvendësohen me fjalët "data 31 dhjetor 2024".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2024.

Miratuar në datën 4.4.2024.

Shpallur me dekretin nr. 151, datë 17.4.2024, të Prestidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 151, datë 17.4.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 31/2024, "Për një ndryshim në ligjin nr. 55/2015, 'Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar"'.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 34/2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 94/2017, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, ORGANIKËS DHE KLASIFIKIMIT TË PAGAVE TË PERSONELIT TË KOMISIONERËVE PUBLIKË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës, neneve 18, pika 1, e 29, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe nenit 55 të rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionerëve Publikë,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Lidhja nr. 1 e vendimit të Kuvendit nr. 94/2017, "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionerëve Publikë", i ndryshuar, ndryshohet sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 prill 2023.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 11.4.2024.

Lidhja nr. 1

ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE TË KOMISIONERËVE PUBLIKË

FUNKSIONI ORGANIK	Klasifikimi i pagës	Numri
I. KOMISIONERI PUBLIK		(4)
Komisionerë Publikë	G3*	2
Sekretarë	Sekretar në kabinetin e ministrit**	2
II. KANCELAR	I-1	(1)
III. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR		(10)
Këshilltarë juristë	80% e pagës G3*	6
Këshilltarë ekonomistë	80% e pagës G3*	4
IV. DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN DHE PUBLIK		(7)
Drejtor	I-4	1
Specialist sekretarie	IV-1	2
Specialist Redaktor gjuhësor	IV-1	1
Përkthyes	II -1	1
Koordinator për Median dhe Marrëdhëniet me Jashtë	II-1	1
Specialist Pritje me popullin	IV-1	1
V. DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		(8)
Drejtor	I-4	1
Specialist Financë/Buxhet	IV-1	1
Specialist i Burimeve Njerëzore	IV-1	1
Specialist IT***	IV-1	1
Specialist Protokoll/Arkiv****	IV-1	1
Magazinier	VI	1
Punonjës pastrimi	II	1
Shofer/Korrier	V	1
Total		**30**

Shënim

** Sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".*

*** Kategoria e pagës për pozicionin e Sekretarit është sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.*

**** Punonjësit në pozicionin e specialistëve të Teknologjisë së Informacionit përfitojnë shtesën për natyrë të veçantë pune në masën dhe sipas kushteve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.*

***** Punonjësit në pozicionet Specialist Arkivi përfitojnë shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin sipas kushteve dhe masës së përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.*

****** Përfitimet për kushtet e vështira e të dëmshme të shëndetit për punonjësit mbështetës janë sipas përcaktimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve.*

VENDIM
Nr. 35/2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 92/2017, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, ORGANIKËS DHE KLASIFIKIMIT TË PAGAVE TË PERSONELIT TË KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT," I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës; të neneve 18, pika 1, e 29, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe të nenit 55 të rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Lidhja nr. 1, e vendimit të Kuvendit nr. 92/2017, "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit", i ndryshuar, ndryshohet sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, ndërsa efektet financiare për përshtatjen e klasave të pagave në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.5.2023, "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nën-prefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", fillojnë nga data 1 prill 2023.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 11.4.2024.

Lidhja nr. 1

ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE TË KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT

FUNKSIONI ORGANIK	**Klasifikimi i pagës**	**Numri**
		(2)
I. KRYETAR	**G3***	**1**
Këshilltar pranë Mbledhjes së Gjyqtarëve dhe Kryetarit	II-1	1
II. KOLEGJI I GJYQTARËVE		**(6)**
Gjyqtarë	G3*	6
III. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR		**(25)**
Këshilltarë jurist	80% e pagës G3*	14
Këshilltarë ekonomistë	80% e pagës G3*	11

IV. SEKETAR I PËRGJITHSHËM	**I-1**	**1**
V.DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN DHE PUBLIKUN		**(17)**
Drejtor	I-4	1
Specialist sekretarie gjyqësore	IV-1	8
Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve	IV-1	2
Përkthyes	II -1	4
Koordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë	II -1	1
Specialist pritje me popullin	IV-1	1
VI. DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		**(12)**
Drejtor	I- 4	1
Specialist financë/buxhet	IV-1	1
Specialist i burimeve njerëzore	IV-1	1
Specialist IT**	IV-1	2
Specialist protokoll/arkivë***	IV-1	2
Magazinier	VI	1
Punonjës pastrimi	II	2
Shofer/Korrier	V	1
Punonjës mirëmbajtje	III	1
Total		**63**

Shënim.

** Sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".*

*** Punonjësit në pozicionin e specialistëve të teknologjisë së informacionit përfitojnë shtesën për natyrë të veçantë pune në masën dhe sipas kushteve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.*

**** Punonjësit në pozicionet specialist arkivi, përfitojnë shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin sipas kushteve dhe masës së përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.*

***** Përfitimet për kushtet e vështira e të dëmshme të shëndetit për punonjësit mbështetës janë sipas përcaktimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore.*

VENDIM
Nr. 36/2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 93/2017, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, ORGANIKËS DHE KLASIFIKIMIT TË PAGAVE TË PERSONELIT TË KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës; si dhe të neneve 18, pika 1, e 29, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe të nenit 55 të rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Lidhja nr. 1, e vendimit të Kuvendit nr. 93/2017, "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit", i ndryshuar, ndryshohet sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 prill 2023.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 11.4.2024.

Lidhja nr.1

ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE TË KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

FUNKSIONI ORGANIK (2)	Klasifikimi i pagës	Numri
I. KRYETAR	G3*	1
Këshilltar pranë Mbledhjes së Komisionerëve dhe Kryetarit	II-1	1
II. KOMISIONERËT	G3*	**(11)**
III. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR	**(36)**	
Këshilltarë jurist	80% e pagës G3*	24
Këshilltarë ekonomistë	80% e pagës G3*	12
IV. SEKRETAR I PËRGJITHSHËM	**I-1**	**(1)**
V. DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN DHE PUBLIKUN	**(15)**	
Drejtor	I-4	1
Specialist sekretarie gjyqësore	IV-1	6
Specialist jurist	IV-1	2
Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve	IV-1	2
Përkthyes	II-1	2
Koordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë	II-1	1
Specialist pritje me popullin	IV-1	1
VI. DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		**(11)**
Drejtor	1-4	1
Specialist financë/buxhet	IV-1	2
Specialist i burimeve njerëzore	IV-1	1
Specialist IT **	IV-1	1
Specialist protokoll/arkivi ***	IV-1	2
Magazinier	VI	1
Punonjës pastrimi	II	2
Shofer/Korrier	V	1
Total		**76**

Shënim.

** Sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".*

*** Punonjësit në pozicionin e specialistëve të teknologjisë së informacionit përfitojnë shtesën për natyrë të veçantë pune në masën dhe sipas kushteve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.*

**** Punonjësit në pozicionet specialist arkiv përfitojnë një shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin, sipas kushteve dhe masës së përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.*

***** Përfitimet për kushtet e vështira e të dëmshme të shëndetit për punonjësit mbështetës janë sipas përcaktimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore.*

VENDIM
Nr. 37/2024

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 98/2014, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT TË POZICIONEVE TË PUNËS TË KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, neneve 9, pika 2, dhe 10, pika 1, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", i ndryshuar, si dhe nenit 11, pika 4, të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Lidhja nr. 2 e vendimit të Kuvendit nr. 98/2014, "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil", i ndryshuar, ndryshohet sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet që nga data 1 prill 2023.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 11.4.2024.

Lidhja nr. 2

ORGANIKA DHE KATEGORIZIMI I POZICIONEVE TË PUNËS TË ZYRËS SË KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Funksioni	**Nr. i punonjësve**	**Kategoria/Klasa**
I. Komisioneri	**1**	**I-F**
	Ligj nr. 9584, dt. 17.07.2006, i ndryshuar me ligjin nr. 34/2023.	
II. Kabineti	**(2)**	
Këshilltar	1	I-4
Sekretar	1	
III. Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes		**(21)**
Drejtor i Përgjithshëm	1	I-4
III/1. Drejtoria e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ		**(7)**
Drejtor	1	II-1
Inspektor	6	III-1

III/2. Drejtoria e Mbikëqyrjes	**(7)**	
Drejtor	1	II-1
Inspektor	6	III-1
III/3. Drejtoria e Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit		**(6)**
Drejtor	1	II-1
Inspektor	5	III-1
IV. Drejtoria e Çështjeve Juridike	**(5)**	
Drejtor	1	II-1
Specialist	4	IV-1
V. Drejtoria e Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse		**(8)**
Drejtor	1	II-1
Specialist (IT)	1	IV-1
Specialist (Marrëdhëniet me Publikun dhe Burimet Njerëzore)	1	IV-1
Specialist (Financë/Buxhet)	1	IV-1
Specialist Arkiv/Protokoll	1	IV-3
Punonjës Mirëmbajtjeje	1	VKM 326, dt. 31.05.2023
Shofer	1	VKM 326, dt. 31.05.2023
Pastrues	1	VKM 326, dt. 31.05.2023
Gjithsej	**37** punonjës	

VENDIM
Nr. 38/2024

PËR EMËRIMIN E ZONJËS MIMOZA KAÇI, ANËTARE E BORDIT TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE, NË FUNKSIONIN E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Në mbështetje të nenit 6 të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar, si dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Këshillit të Ministrave me VKM-në nr. 641, datë 22.11.2023, "Për propozimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të kandidaturës së një anëtari të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për ushtrimin e funksionit të drejtorit të përgjithshëm ekzekutiv të Autoritetit",

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Mimoza Kaçi, anëtare e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, e cila mban funksionin e nëndrejtorit ekzekutiv, lirohet nga ky funksion dhe emërohet në funksionin e drejtorit të përgjithshëm ekzekutiv të Autoritetit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 11.4.2024.

VENDIM
Nr. 39/2024

PËR ZGJEDHJEN E ZONJËS FATJOLA DELIJA ANËTARE TË KOMISIONIT TË KONKURRENCËS

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, neneve 20, 21 dhe 22 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar, si dhe neneve 55 e 111 të rregullores së Kuvendit, me propozim të një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Fatjola Delija zgjidhet anëtare e Komisionit të Konkurrencës.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 11.4.2024.

VENDIM
Nr. 40/2024

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR "PËR TË KOORDINUAR DHE MBIKËQYRUR TË GJITHA VEPRIMET INSTITUCIONALE PËR TË LUFTUAR DEZINFORMIMIN DHE FORMAT E TJERA TË NDËRHYRJES SË HUAJ NË PROCESET DEMOKRATIKE TË VENDIT"

Në mbështetje të neneve 77, pika 1, dhe 78, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 24 dhe 55, pika 1, të rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngritjen e Komisionit të Posaçëm të Kuvendit "Për të koordinuar dhe mbikëqyrur të gjitha veprimet institucionale për të luftuar dezinformimin dhe format e tjera të ndërhyrjes së huaj në proceset demokratike të vendit".

II. Komisioni ka objekt të veprimtarisë së tij:

- të nxitë identifikimin e ndërhyrjes së huaj në proceset demokratike përmes një sërë formash, duke përfshirë fushat e dezinformimit nëpërmjet medieve tradicionale dhe atyre sociale për formësimin e opinionit publik, mbështetjen financiare të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, si dhe ndikimin keqdashës ekonomik të aktorëve publikë dhe minimin e veprimtarisë së shoqërisë civile;

- të kryejë një analizë të plotë të të gjithë faktorëve dhe fenomeneve për të vlerësuar nëse janë respektuar detyrimet ligjore në fuqi në lidhje me transparencën në proceset demokratike, veçanërisht transparencën e financimeve në fushata zgjedhore, si dhe transparencën e financimit të të gjithë aktorëve dhe platformave që ofrojnë shërbime në sektorin e informimit publik apo veprimtari të tjera të ngjashme me to;

- të identifikojë masat administrative dhe ndërhyrjet e mundshme nëpërmjet ndryshimit apo plotësimit të legjislacionit në fuqi për të adresuar zgjidhjen e problematikave të identifikuara, veçanërisht në drejtim të rritjes së përgjegjshmërisë së platformave dhe medieve sociale për të klasifikuar përmbajtjen e lajmeve/informacioneve që shpërndahen nga robotët, duke rishikuar algoritmet, me qëllim bërjen transparente të faktorëve ku bazohen për të shfaqur, për t'i dhënë përparësi, shpërndarë ose hequr përmbajtjen e lajmit/ informacionit, si dhe pa cenuar lirinë e shprehjes, për të mbyllur llogaritë e personave/subjekteve që përfshihen në sjellje të koordinuara joautentike në internet ose aktivitete të paligjshme, që synojnë minimin sistematik të proceseve demokratike ose nxitjen e gjuhës së urrejtjes.

III. Komisioni përbëhet nga 11 anëtarë, që përfaqësojnë të gjitha grupet parlamentare, dhe drejtohet nga përfaqësuesi i shumicës parlamentare. Anëtarët e Komisionit caktohen me vendim Kuvendi.

IV. Komisioni e ushtron veprimtarinë për një afat 1-vjeçar nga data e miratimit të këtij vendimi. Kuvendi mund të vendosë të zgjatë afatin e ushtrimit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm sipas përcaktimeve në rregulloren e Kuvendit.

V. Nisur nga natyra e veçantë e çështjeve që ka për objekt veprimtarie, pranë Komisionit të Posaçëm do të ketë një grup ekspertësh si përfaqësues të institucionit të Presidentit të Republikës, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Drejtësisë, Shërbimit Informativ Kombëtar, Agjencisë së Inteligjencës Financiare, Autoritetit të Mediave Audiovizive, si dhe institucioneve të tjera që Komisioni do të vlerësojë se mund të kontribuojnë me ekspertizë në veprimtarinë e tij.

Komisioni mund të kërkojë edhe ekspertizë nga BE-ja, NATO-ja, SHBA-ja, si dhe të angazhojë ekspertë vendas dhe/ose të BE-së, NATO-s dhe ekspertë nga SHBA-ja, që të punojnë bashkë me grupin e ekspertëve vendas sipas kërkesave të Komisionit dhe caktimit të detyrave përkatëse.

VI. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për krijimin e kushteve të punës, si dhe për mbështetjen me burime njerëzore, financiare dhe logjistike të veprimtarisë së Komisionit dhe të grupit të ekspertëve të ngritur pranë tij.

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 11.4.2024.

VENDIM
Nr. 41/2024

PËR MOSDËRGIMIN E MOCIONIT NË GJYKATËN KUSHTETUESE

Në mbështetje të nenit 70, pikat 3 dhe 4, të Kushtetutës, neneve 55 dhe 119/1 të rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, bazuar në raportet dërguar seancës plenare nga Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosdërgimin e mocionit mbi papajtueshmërinë e mandatit të deputetes Olta Xhaçka në Gjykatën Kushtetuese.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 11.4.2024.

URDHËR
Nr. 40, datë 5.4.2024

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCËS PËR MBIKËQYRJEN E VEPRIMTARISË ADMINISTRATIVE TË AGJENCISË SË MENAXHIMIT TË GARANCIVE DHE KREDIVE TË PAKTHYERA

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë", si dhe të neneve 22 dhe 23, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës për ushtrimin e mbikëqyrjes institucionale të veprimtarisë administrative të Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera (AMGKP), te znj. Risena Xhaja, Sekretar i Përgjithshëm, në Ministrinë e Financave, deri në emërimin e titullarit të AMGKP-së, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Ngarkohet znj. Risena Xhaja, të ushtrojë kompetencat e mbikëqyrjes së këtij institucioni sipas ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore".
3. Ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Ministrinë e Financave për komunikimin e këtij urdhri, si dhe Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera për zbatimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet ne Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Ervin Mete

URDHËR
Nr. 120, datë 12.4.2024

PËR DELEGIMIN E KRYERJES SË DETYRAVE QË KANË TË BËJNË ME PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; të pikës 5, të nenit 21, të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", të ndryshuar; të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar; të pikës 2, të nenit 26, dhe germës "i", të nenit 37, të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; të pikës 2, të nenit 73, të vendimit të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"; të udhëzimit nr. 4, datë 18.6.2021, "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik"; si dhe të udhëzimit nr. 7, datë 30.7.2021, "Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, kancelarit, z. Saimir Shyti, për kryerjen e detyrave dhe nënshkrimin e akteve për të gjitha procedurat e prokurimit pranë kësaj gjykate.
2. Organi i deleguar nuk mund ta nëndelegojë këtë kompetencë.
3. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit.
4. Ngarkohet kancelari, z. Saimir Shyti, për zbatimin e këtij urdhri.
5. Ky urdhër hyn në fuqi më datë 12.4.2024 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVËNDËSKRYETAR
Erjon Bani

URDHËR
Nr. 278, datë 11.4.2024

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural zëvendësministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, z. Roland Kristo, nga data 12.4.2024 deri më datë 15.4.2024.

2. Në ushtrim të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sipas pikës 1 të këtij urdhri, zëvendësministri ushtron këto përgjegjësi kryesore:

a) trajton dhe nënshkruan përgjigjet zyrtare drejtuar institucioneve shtetërore, personave fizikë ose juridikë, publikë ose privatë, për të gjitha çështjet që janë brenda fushës së veprimtarisë të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe që lidhen me ushtrimin e funksionit të drejtimit administrativ të institucionit, përveç kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor;

b) ndjek dhe kontrollon veprimtarinë e nëpunësve të aparatit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe institucioneve të varësisë të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

c) bën ndarjen dhe mbikëqyr realizimin e detyrave nga nëpunësit e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në funksion të drejtimit dhe administrimit të përditshëm të veprimtarisë së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

3. Në ushtrimin e kompetencave, sipas këtij urdhri, zëvendësministri ndihmohet dhe mbështetet nga sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ose personi që ushtron detyrat e tij në rast mungese.

4. Zëvendësministri ndalohet të nëndelegojë te një organ i tretë kompetencat e përfituara përmes këtij akti delegimi.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, z. Roland Kristo.

6. Ky urdhër hartohet në 3 (tre) kopje të njëjta 1 (një) për arkiv/protokollin, 1 (një) për Qendrën e Botimeve Zyrtare dhe 1 (një) për zëvendësministrin, z. Roland Kristo.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

VENDIM
Nr. 16, datë 12.3.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Marsida Xhaferllari	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 12.3.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 14 (E) 2023 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Elisabeta Cara, përfaqësuar nga avokatët Rudin Birçaj dhe Erlis Nakollari.

SUBJEKT I INTERESUAR: Posta Shqiptare sh.a., Filiali Fier, përfaqësuar nga Suela Prifti, drejtore filiali.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-3578, datë 7.12.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*;

neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)*; nenet 27 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim pretendimet e kërkueses Elisabeta Cara, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, Postës Shqiptare sh.a., Filiali Fier (*Posta Shqiptare*) që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, mendimin me shkrim të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Elisabeta Cara ka qenë në marrëdhënie pune pranë Postës Shqiptare, me detyrë shpërndarëse e postës, për periudhën 3.3.2008–13.3.2014. Me vendimin nr. 18, datë 13.3.2014, asaj i është dhënë masa disiplinore e largimit nga detyra, për shkak të konstatimit të mangësive në punë. Kërkuesja, duke pretenduar se kontrata e punës është zgjidhur në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padi për dhënien e dëmshpërblimeve respektive, sipas përcaktimeve në Kodin e Punës.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 62-2015-59 (24), datë 14.1.2015, ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se kontrata ishte zgjidhur në mënyrë të menjëhershme dhe për shkaqe të justifikuara në përputhje me nenet 153 dhe 154 të Kodit të Punës.

3. Mbi ankimin e kërkueses, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 921, datë 14.7.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me të njëjtin arsyetim. Ajo ka vlerësuar se nga kërkuesja nuk janë zbatuar detyrat në zonën që ajo ka kryer shërbimin e postierit dhe, për rrjedhojë, masa disiplinore e largimit nga puna ka qenë e bazuar. Kundër këtij vendimi kërkuesja ka paraqitur rekurs.

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-3578, datë 7.12.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*). Sipas Gjykatës së Lartë, gjykatat më të ulëta e kanë respektuar ligjin material, duke e interpretuar dhe zbatuar drejtë atë dhe vendimet e dhëna prej tyre nuk janë në kundërshtim me ndonjë vendim të kësaj gjykate, ndërsa pjesa e pretendimeve që ngre çështje të vlerësimit të provave, del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të saj.

5. Në vijim, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesën, sipas objektit, e cila është regjistruar në këtë Gjykatë më datë 30.6.2023.

6. Kolegji i Gjykatës, i mbledhur më datë 5.10.2023, ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, ndërsa kjo e fundit, me vendimin e datës 11.10.2023, bazuar në nenin 31, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kthimin e kërkesës për plotësim aktesh kërkueses me qëllim paraqitjen e argumenteve dhe provave lidhur me respektimin e afatit ligjor 4-mujor të paraqitjes së ankimit kushtetues individual. Më datë 26.10.2023 kërkuesja ka paraqitur argumentet për datën e marrjes dijeni të vendimit të kundërshtuar. Në vijim, Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin e datës 6.11.2023, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

7. Me vendimin nr. 505, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor (*KLGJ*) "Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm", Gjykata e Apelit Vlorë ka ndërprerë veprimtarinë më datë 31.1.2023 dhe funksionet e saj ushtrohen nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me seli në Tiranë. Ndërsa me vendimin nr. 131, datë 28.3.2023 të KLGJ-së "Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier", kjo gjykatë prej datës 1.5.2023 ka zëvendësuar Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Në këto rrethana, në tekstin e këtij vendimi, këto institucione janë referuar me emrat përkatës gjatë kohës së lëshimit të vendimeve gjyqësore të tyre.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. *Kërkuesja*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se Gjykata e Lartë i ka cenuar:

8.1 *Të drejtën për proces të rregullt ligjor,* të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

8.1.1 *Parimit të kontradiktoritetit, së drejtës për t'u mbrojtur dhe dëgjuar*, pasi nuk i është dhënë mundësia të argumentojë shkaqet e rekursit. Gjykata e Lartë nuk ka analizuar nëse kanë ekzistuar ose jo shkaqet e justifikuara për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës. Njoftimet e kryera nga punëdhënësi janë absolutisht të pavlefshme dhe bien ndesh me nenin 37 të Kodit të Punës, pasi nuk i është garantuar e drejta për t'u dëgjuar, mbrojtur dhe për të parashtruar fakte dhe prova brenda një afati të arsyeshëm. Punëdhënësi nuk ka argumentuar se cilën pikë të rregullores së punës ka shkelur kërkuesja dhe masat disiplinore nuk janë regjistruar në regjistrin e punonjësit. Ai nuk ka respektuar as afatin ligjor 3- mujor të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës. Gjykata e Lartë ka vepruar ndryshe nga qëndrimi i saj i mëparshëm, sikurse në vendimet nr. 00-2022-2325 (334), datë 28.9.2022 dhe nr. 00-2023-1131 (99), datë 1.3.2023.

8.1.2 *Parimit të sigurisë juridike*, pasi Gjykata e Lartë jo vetëm duhej ta kishte kaluar çështjen për shqyrtim në seancë plenare me praninë e palëve, por duhej të niste edhe njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore. Qëndrimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar kërkueses pritshmëritë për ndryshimin e një situate të pafavorshme ligjore ndaj saj.

8.1.3 *Parimit të ligjshmërisë*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka analizuar veprimet e punëdhënësit për vendosjen e masave disiplinore ose afateve dhe shkaqeve në zgjidhjen e kontratës së punës, duke iu referuar kërkesave të neneve 37 dhe 143 të Kodit të Punës.

8.2 *Parimin e mosdiskriminimit*, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi nëse Gjykata e Lartë do ta kishte shqyrtuar çështjen në seancë me praninë e palëve, do të kishte konstatuar se shkaqet e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës lidhen me arsye fetare dhe politike. Kërkuesja është praktikante e fesë myslimane, e persekutuar politike gjatë regjimit komunist dhe e orientuar me ide politike të djathta.

9. *Subjekti i interesuar, Posta Shqiptare,* në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar:

9.1 Pretendimi i kërkueses për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* është i pabazuar, pasi në rastin e saj janë respektuar afatet ligjore në procedurën e ndjekur dhe zgjidhja e marrëdhënieve të punës ka qenë e justifikuar, për shkak të shkeljeve disiplinore të përsëritura dhe qëndrimit jo korrekt të kërkueses në detyrën që i ishte ngarkuar.

9.2 Pretendimi për cenimin e *parimit të mosdiskriminimit* nuk qëndron, pasi kërkueses i janë sqaruar arsyet e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, megjithëse ajo ka pretenduar se kjo bëhej për arsye politike.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

10. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Gjykata çmon se kërkuesja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës "f" të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës "i" të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Në analizë të kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, mbështetur në nenin 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesja i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm, duke pretenduar cenimin e procesit të rregullt ligjor, si dhe faktin se shkaqet e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës lidheshin me orientimin fetar dhe politik.

13. Për sa i takon pretendimit se zgjidhja e marrëdhënieve të punës ka qenë për shkak të bindjeve fetare, Gjykata vëren se në dosjen

gjyqësore, me kërkesë të punëdhënësit, Postës Shqiptare, është administruar si provë praktika e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Ky i fundit ka kryer, *ex officio*, shqyrtimin e çështjes dhe në përfundim, me vendimin nr. 80, datë 29.5.2014, ka vlerësuar se kërkuesja nuk është diskriminuar për shkak të bindjeve fetare nga ana e drejtuesit të Postës Shqiptare. Nga ana tjetër, Gjykata konstaton se pretendimi për diskriminim në marrëdhëniet e punës për shkak të bindjeve fetare nuk rezulton të jetë parashtruar prej kërkueses gjatë procesit administrativ dhe në asnjë shkallë të procesit gjyqësor, por është artikuluar për herë të parë në ankimin kushtetues individual. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive që ka pasur në dispozicion, ndaj ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

14. Kërkuesja ka pretenduar, gjithashtu, se është diskriminuar në marrëdhëniet e punës për shkak të bindjeve politike dhe përkatësinë shoqërore në kategorinë e të persekutuarve politikë. Gjykata vëren se ky shkak diskriminimi është deklaruar gjatë procesit administrativ (procesverbalet e mbledhjeve të datave 6.11.2013 dhe 13.3.2014 të përpiluara nga punëdhënësi). Po kështu, ajo ka kundërshtuar në gjykatë zgjidhjen e kontratës së punës për shkaqe të pajustifikuara, të cilat nuk i ka specifikuar në aktin e padisë, por gjatë gjykimit ajo ka përmendur, si të tilla, edhe ato me natyrë diskriminuese të lidhura me bindjet politike dhe përkatësinë shoqërore të saj (procesverbali audio i seancës gjyqësore i datës 7.11.2014). Ndërkohë, ky pretendim rezulton se është prapësuar në gjykimin në shkallë të parë edhe nga subjekti i interesuar (prapësimet me shkrim të datës 12.6.2014), si dhe është pasqyruar në vendimin përfundimtar të gjykatës së shkallës së parë. Në vijim, kërkuesja ka paraqitur apel dhe rekurs, akte në të cilat ka kundërshtuar zgjidhjen e kontratës sërish për shkaqe të pajustifikuara, të cilat, referuar akteve në gjykim, përfshinin edhe ato për diskriminim. Në këtë situatë dhe duke mbajtur në konsideratë se argumenti kryesor i kërkueses për kundërshtimin e zgjidhjes së kontratës së punës lidhej me shkaqet e pajustifikuara, ku përfshihej edhe ai i diskriminimit për shkak të bindjeve politike, Gjykata çmon se kërkuesja ka shteruar mjetet ligjore në dispozicion për këtë pretendim.

15. Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektet e parimit të kontradiktoritetit, së drejtës për t'u mbrojtur dhe dëgjuar, parimit të sigurisë juridike dhe ligjshmërisë, Gjykata vlerëson se kërkuesja nuk ka më mjete të tjera ankimi në dispozicion për mbrojtjen e tyre përveç ankimit kushtetues individual.

16. Për sa i takon legjitimimit *ratione temporis,* bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4-muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Gjykata ka pranuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose me njoftimin elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.9.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesja ka kundërshtuar procesin gjyqësor që është përmbyllur me vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 7.12.2022. Me shkresën nr. 3955/1 prot., datë 18.7.2023, Gjykata e Lartë ka informuar se vendimi është publikuar në faqen zyrtare të saj më datë 6.2.2023, ndërsa ankimin kushtetues individual kërkuesja e ka paraqitur nëpërmjet shërbimit postar më datë 27.6.2023, pra pas 4 muajve e 21 ditëve nga publikimi i vendimit.

18. Kërkuesja fillimisht ka pretenduar se vendimi objekt i ankimit kushtetues i është komunikuar më datë 25.4.2023 nga kryesekretaria e gjykatës së Fierit, pasi nga Gjykata e Lartë nuk i ka ardhur asnjë njoftim, duke mos argumentuar përmbushjen e standardeve kushtetuese për momentin e konstatimit të cenimit. Në këto rrethana, Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin e ndërmjetëm të datës 11.10.2023, ka vendosur kthimin e akteve kërkueses për plotësim me qëllim paraqitjen e argumenteve dhe provave lidhur me respektimin e afatit ligjor 4-mujor të paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

19. Me paraqitjen e akteve shtesë, rezulton se kërkuesja më datë 27.4.2023, kur ishte ende brenda afatit ligjor 4-mujor, ka kërkuar ndihmë juridike dytësore, falas, për shkak të situatës së saj ekonomike, me qëllim përgatitjen e ankimit kushtetues individual, kërkesë e cila është pranuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier me vendimin e datës 18.5.2023. Në këto rrethana, duke mos llogaritur kohën gjatë së cilës gjykata e zakonshme ka shqyrtuar dhe miratuar

kërkesën për ndihmë juridike falas, Gjykata vlerëson se ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, për rrjedhojë kërkuesja legjitimohet *ratione temporis*.

20. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesja ka pretenduar se Gjykata e Lartë i ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimeve të kontradiktoritetit, së drejtës për t'u mbrojtur dhe dëgjuar, sigurisë juridike dhe ligjshmërisë, si dhe parimin e mosdiskriminimit, të garantuara nga nenet 18 dhe 42 të Kushtetutës.

21. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike, kërkuesja ka parashtruar se Gjykata e Lartë duhej të bënte njësimin/ndryshimin e praktikës gjyqësore, sepse në dy raste të tjera ka dhënë vendime që binin ndesh me vendimin e dhënë për të. Në këtë pikë, Gjykata vë në dukje se ndonëse çështja e kërkueses ka ngjashmëri me dy çështje të tjera të shqyrtuara nga Gjykata e Lartë, sepse kanë për objekt zgjidhjen e padrejtë të marrëdhënieve të punës, bazuar në dispozitat e Kodit të Punës, secila prej tyre ka specifikat dhe individualitetin e saj në drejtim të llojit të detyrës dhe shkeljes që ka shërbyer për zgjidhjen e kontratës së punës. Kjo nënkupton se mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit për secilën prej tyre vlerësohet nga gjykata e zakonshme në kontekstin e fakteve dhe provave të çështjes konkrete, të cilat nuk mund të jenë të njëjta. Nën këtë analizë, Gjykata vlerëson se ky pretendim nuk është ngritur në nivel kushtetues dhe, si i tillë, nuk mund të merret në shqyrtim.

22. Për sa u takon pretendimeve për cenimin e parimeve të kontradiktoritetit, së drejtës për t'u mbrojtur dhe dëgjuar, si dhe ligjshmërisë, kërkuesja ka parashtruar disa argumente, të cilat bazohen në faktin se Gjykata e Lartë nuk ka analizuar nëse ekzistojnë ose ajo shkaqet e justifikuara për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës. Duke pasur parasysh thelbin e argumenteve, Gjykata vlerëson t'i analizojë ato në këndvështrim të standardit të arsyetimit të vendimit, duke vënë në dukje se e drejta për proces të rregullt ligjor, në aspektin e arsyetimit të vendimit, garantohet nga neni 42 i Kushtetutës.

23. Ndërsa lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të mosdiskriminimit për shkak të bindjeve politike, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës dhe neni 14 i KEDNJ-së, Gjykata, rithekson se ai nuk mund të qëndrojë më vete, por duhet të jetë i lidhur ngushtësisht me ndonjë të drejtë tjetër themelore të parashikuar në Kushtetutë (*shih vendimin nr. 33, datë 12.9.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Nën këtë optikë, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë, nga njëra anë, faktin se për këtë pretendim gjykatat nuk janë shprehur në vendimmarrjen e tyre dhe, nga ana tjetër, se argumentet e kërkueses, në thelb, kanë të bëjnë me të drejtën kushtetuese për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme, ajo do ta analizojë çështjen në këndvështrim të standardit të arsyetimit të vendimit të lidhur me parimin e mosdiskriminimit dhe me të drejtën për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme, sipas neneve 18, 42 dhe 49 të Kushtetutës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit të lidhur me parimin e mosdiskriminimit dhe të drejtën për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme

24. Kërkuesja ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka analizuar nëse kanë ekzistuar ose jo shkaqet e justifikuara për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës. Sipas saj, shkaqet e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës lidhen me arsye politike, duke qenë se ajo është e persekutuar politike dhe e orientuar me ide politike të djathta. Për këtë qëllim ajo ka paraqitur vërtetimin nr. E-238/1 prot., datë 20.11.2018 të Ministrisë së Brendshme, me të cilin i është njohur koha e dëbimit nga Tirana në Fier në periudhën 12.2.1966–29.6.1990, për çështje politike.

25. Subjekti i interesuar, Posta Shqiptare, ka prapësuar në mënyrë të vazhdueshme se kërkuesja nuk ka realizuar punën e ngarkuar dhe për këtë shkak ndaj saj është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna" dhe është penalizuar me mbajtjen e 10% të pagës mujore. Sipas tij, kërkuesja nuk paraqitej në punë dhe nga qytetarët kishte ankesa për shpërndarjen e faturave, prandaj nisën procedurat për dhënien e masës disiplinore të largimit nga puna, të cilat u finalizuan me vendimin e datës 13.3.2014.

26. Në nenin 42 pika 2, të Kushtetutës parashikohet, ndër të tjera, se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Kurse, neni 49, po aty, garanton që secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë (*pika 1*). Nga ana tjetër, Kushtetuta në nenin 18 të saj parashikon parimin themelor të barazisë përpara ligjit, sipas të cilit, askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht, ndër të tjera, mbi baza të bindjeve

politike ose gjendjes sociale (*pika 2*) dhe se askush nuk mund të diskriminohet për këto shkaqe, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.

27. Gjykata ka pohuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Lidhur me vendimet e mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë, Gjykata ka vënë në dukje se, si rregull, arsyetimi i kufizuar i tyre nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor (*shih vendimet nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 9, datë 26.3.2018; nr. 8, datë 26.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*), por kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to *(shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 11, datë 16.4.2018; nr. 45, datë 3.7.2017 të Gjykatës Kushtetuese)*.

28. Për sa i takon nenit 49, pika 1, të Kushtetutës, Gjykata është shprehur se kjo e drejtë kushtetuese përfshin, ndër të tjera, zgjedhjen e profesionit dhe vendit të punës, me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. E drejta për të përfituar me punë të ligjshme fiton rëndësi edhe nga pikëpamja sociale, pasi puna si profesion është një vlerë edhe për kontributin që i sjell shoqërisë në tërësi (*shih vendimet nr. 1, datë 25.1.2024; nr. 17, datë 23.3.2023; nr. 9, datë 23.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Ndërsa lidhur me parimin e mosdiskriminimit, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se ai synon që të gjithë të jenë të barabartë në/përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta, dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë *(shih vendimet nr. 31, datë 4.10.2021; nr. 27, datë 29.6.2021; nr. 10, datë 29.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Po kështu, Gjykata vë në dukje se Shqipëria është shtet anëtar me të drejta dhe detyrime të plota i Konventës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave" (*Konventa e CEDAW*), e cila ka sanksionuar detyrimin e shteteve palë për të marrë të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj gruas në çështje të tilla që lidhen me të drejtën për punë si një e drejtë e pamohueshme, të drejtën për të zgjedhur lirisht profesionin dhe vendin e punës, të drejtën për punë të qëndrueshme, për të gjitha përfitimet dhe kushtet e punës, si dhe një sërë të drejtash të tjera që rrjedhin nga punësimi *(neni 11*).

31. Mbrojtja nga diskriminimi gjendet i parashikuar specifikisht edhe në nenin 14 të KEDNJ-së, i cili ndalon shprehimisht kufizimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të garantuara nga kjo Konventë për shkaqe të ndryshme, ku përfshihen edhe pikëpamjet politike dhe prejardhja sociale. Kjo mbrojtje përforcohet edhe nga neni 1 i Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, i cili ndalon në çdo rast diskriminimin edhe në gëzimin e të drejtave të parashikuara nga ligji.

32. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) ka theksuar se neni 14 i KEDNJ-së gjen zbatim edhe kur shtetet, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, nuk i trajtojnë ndryshe personat situatat e të cilëve janë thelbësisht të ndryshme (*shih Eweida dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 15.1.2013, § 87*). Sipas saj, edhe pse neni 14 i KEDNJ-së nuk jep një përkufizim, diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet si "*dallim në trajtim i personave në situata të njëjta ose të ngjashme*" dhe "*bazuar në një karakteristikë ose "status" të dallueshëm*" (*shih Biao kundër Danimarkës [DhM], datë 24.5.2016, § 89*).

33. Nga ana tjetër, kuadri ligjor ofron disa garanci për mbrojtjen nga diskriminimi në marrëdhëniet e punës. Kështu, neni 9 i Kodit të Punës parashikon ndalimin e çdo forme diskriminimi në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion (*pika 1*). Me "*diskriminim*", sipas këtij kodi, kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet, ndër të tjera, në bindjet politike dhe gjendjen shoqërore ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët (*pika 2*). Në të njëjtën linjë, ligji nr. 10221, datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar (*ligji nr. 10221/2010*), ka rregulluar në mënyrë të posaçme parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit, të lidhur, ndër të tjera, me shkakun e bindjeve politike dhe gjendjen shoqërore (*neni 1*). Sipas ligjit, me "diskriminim" kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar

në cilindo shkak të përcaktuar në të, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta, aktet ndërkombëtare të ratifikuara, si dhe nga ligjet në fuqi (*neni 3, pika 1, i ligjit nr. 10221/2010*).

34. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se kërkuesja ka qenë në marrëdhënie pune pranë Postës Shqiptare, me detyrë shpërndarëse e postës për 6 vjet. Më datë 13.3.2014, asaj i është dhënë masa disiplinore e largimit nga detyra, me arsyetimin se kishte pasur mangësi në punë. Kërkuesja ka ngritur padi në gjykatë, duke pretenduar se zgjidhja e marrëdhënieve të punës ishte rrjedhojë e shkaqeve të pajustifikuara, që lidheshin me arsyet politike dhe statusin shoqëror të saj. Më konkretisht, ajo ka përdorur termat "*bindje politike/luftë e klasave/e persekutuar*" (*shih procesverbalet nr. 53, datë 6.11.2013, nr. 22, datë 13.3.2014, nr. 227/2 prot., datë 13.3.2014 të mbledhjeve të punëdhënësit; procesverbalin gjyqësor të seancës së 7.11.2014 dhe regjistrimi audio minuta 11:18; prapësimet e punëdhënësit të datës 12.6.2014 të paraqitura në gjykimin në shkallë të parë*). Këtij pretendimi, punëdhënësi i është përgjigjur se barra e provës, për të vërtetuar diskriminimin për shkaqe politike, i takon kërkueses, sipas nenit 146 të Kodit të Punës (*shih faqen 4 të prapësimeve të datës 12.6.2014*), duke mbajtur qëndrimin se shkaqet e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës lidheshin me mangësitë në punë dhe, për rrjedhojë, ishin të justifikuara.

35. Po kështu, Gjykata vë në dukje se as gjykata e shkallës së parë, as ajo e apelit nuk e kanë shqyrtuar në themel pretendimin e kërkueses për diskriminim, por duket se kanë mbajtur qëndrim formalist në shqyrtimin e akteve. Ndonëse ato e kanë pasqyruar në tekstin e vendimeve pretendimin për diskriminim për arsye politike dhe prapësimet e punëdhënësit, në arsyetimin e vendimeve janë mjaftuar me konkluzionin e paraqitur nga punëdhënësi se kërkuesja ka vepruar me faj të rëndë, duke mos zbatuar detyrimet e saj kontraktore, sipas parashikimeve të Kodit të Punës, gjë e cila ka sjellë zgjidhjen e menjëhershme dhe për shkaqe të justifikuara të kontratës së punës. Ndërsa, Gjykata e Lartë, me arsyetim të kufizuar, ka vlerësuar se në gjykimin e çështjes së kërkueses nuk rezultonte të ishin lejuar shkelje procedurale që do ta bënin të pavlefshëm procesin dhe do të ndikonin në vendimmarrjen e gjykatave. Sipas saj, gjykatat më të ulëta e kanë respektuar ligjin material, duke e interpretuar dhe zbatuar drejtë atë, dhe se vendimet e dhëna prej tyre nuk janë në kundërshtim me ndonjë vendim të vetë asaj gjykate.

36. Gjykata vëren se kërkuesja ka parashtruar disa fakte me rëndësi në drejtim të diskriminimit në punë. Kështu, ajo i përket një kategorie të veçantë shoqërore – të përndjekurve politikë gjatë regjimit komunist. Ajo kishte filluar marrëdhëniet e punës në një shoqëri aksionere me kapital shtetëror (Posta Shqiptare sh.a.) në vitin 2008. Pas zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të vitit 2013, të cilat rezultuan me rotacion politik në qeverisjen qendrore dhe ndryshime të drejtuesve të institucioneve shtetërore, kërkueses iu dhanë në vijimësi 3 masa disiplinore – vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra (8.11.2013), penalizim me mbajtjen e 10% të pagës mujore (10.2.2014) deri në largimin nga detyra (13.3.2014). Vetë kërkuesja ka parashtruar se, për shkak të statusit shoqëror, ka bindje politike të kundërta me shumicën qeverisëse, që, sipas saj, ishin shkaku i vërtetë i zgjidhjes së marrëdhënieve të punës.

37. Në këtë kontekst, Gjykata, bazuar në nenet 18 dhe 49 të Kushtetutës, vlerëson se bindjet politike dhe gjendja sociale janë rrethana, të cilat përbëjnë shkak për dallim, përjashtim ose kufizim që sjell si pasojë pengesën për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme. Nën këtë këndvështrim, duke mbajtur në konsideratë se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk janë shprehur për këtë pretendim me natyrë kushtetuese të kërkueses, si dhe qëndrimin e punëdhënësit se barra e provës për të vërtetuar diskriminimin i përkiste asaj, Gjykata çmon se duhet analizuar në rrafshin kushtetues se kujt prej palëve që janë të përfshira në marrëdhëniet e punës (punëdhënës dhe/ose punëmarrës) i takon barra e provës.

38. GJEDNJ-ja, gjatë shqyrtimit të çështjeve ku është ngritur pretendimi për diskriminim, ka përcaktuar se, pasi kërkuesi ka treguar një ndryshim në trajtim, i takon shtetit përgjegjës të tregojë se trajtimi i ndryshëm ishte i justifikuar (*shih Timishev kundër Rusisë, datë 13.12.2005, § 57*). Kur Gjykata, bazuar në rrethanat konkrete, pranon që ka një çështje *prima facie* diskriminimi, atëherë barra e provës kalon te shteti përgjegjës për të siguruar justifikimin e tij. Rrethanat specifike të fakteve dhe natyra e pretendimeve në disa raste e bëjnë jashtëzakonisht të vështirë në praktikë për kërkuesin

të provojë diskriminimin, ndaj bëhet i nevojshëm kalimi i barrës së provës tek autoritetet përgjegjëse (*shih Cînța kundër Rumanisë, datë 18.2.2020, §79*).

39. Në mendimin me shkrim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është shprehur se vetëm fakti se punëmarrësi provon se mbart një shkak diskriminimi të mbrojtur me ligj, nuk mjafton për të provuar motivin diskriminues për largimin nga puna. Të provuarit e diskriminimit është i vështirë, ndaj në këto çështje zbatohet parimi i ndarjes së barrës së provës. Autori i diskriminimit shpesh ka kontroll për informacionin e nevojshëm për të provuar diskriminimin dhe për më tepër që kush diskriminon nuk do të pranonte kurrë qëllimin për të diskriminuar. Sipas Komisionerit, gjykata në shqyrtimin e çështjeve të diskriminimit duhet të bëjë ndarjen e barrës së provës, ku paditësi mund të tregojë disa fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka ndodhur diskriminimi dhe barra e provës bie mbi të padituri që të provojë të kundërtën. Në këtë rast, i padituri duhet të vërtetojë se arsyeja pas trajtimit nuk ka asnjë lidhje me shkakun e mbrojtur/shkakun diskriminues dhe nëse shpjegimi i tij nuk është i përshtatshëm, atëherë gjykata duhet ta shpallë diskriminimin të vërtetuar.

40. Për sa më lart, Gjykata thekson se neni 18 i Kushtetutës, që parashikon ndalimin e diskriminimit, para së gjithash, sanksionon një detyrim negativ, sipas të cilit askush të mos diskriminohet padrejtësisht për shkaqe që lidhen, ndër të tjera, me bindjet politike ose me gjendjen shoqërore. Në këtë pikë, Gjykata evidenton se aty ku ekzistojnë fakte nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim, i takon autorit të diskriminimit, në këtë rast punëdhënësit, të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të këtij parimi. Kalimi i barrës së provës nga punëmarrësi (*viktima e diskriminimit)* te punëdhënësi (*autori i diskriminimit)* lidhet me vulnerabilitetin e të diskriminuarit, ndaj ai mjafton të paraqesë fakte të besueshme që prezumojnë *prima facie* ekzistencën e një rrethane specifike diskriminuese që ka çuar në një trajtim më pak të favorshëm ose në shkaktimin e dëmit ndaj tij. Nga ana tjetër, gjykata ka detyrën për të verifikuar nëse faktet e pretenduara ekzistojnë dhe të vlerësojë nëse provat e paraqitura nga punëdhënësi janë të mjaftueshme për të nxjerrë konkluzionin se zgjidhja e marrëdhënieve të punës nuk ka qenë për shkaqe diskriminuese. Me fjalë të tjera, kjo do të thotë se barra e provës në lidhje me shkaqet për diskriminim në marrëdhëniet e punës i përket fillimisht punëmarrësit, por nëse ky i fundit paraqet disa fakte, të cilat mbështesin në mënyrë të arsyeshme një prezumim për diskriminim, barra e provës kalon te punëdhënësi.

41. Duke iu rikthyer edhe njëherë çështjes konkrete, Gjykata vlerëson se në kushtet kur "*bindjet politike*" dhe "*gjendja shoqërore*" përbëjnë shkaqe kushtetuese për diskriminim të padrejtë në marrëdhëniet e punës, gjykatat kishin detyrimin të verifikonin pretendimin e kërkueses dhe t'i jepnin përgjigje të arsyetuar, pasi ai ka qenë vazhdimisht i shprehur prej saj dhe vetë pala paditëse e ka konfirmuar këtë në prapësimet e saj përpara gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, por edhe në prapësimet e paraqitura në gjykimin kushtetues të çështjes. Në këtë proces verifikimi, gjykatat duhej të analizonin në mënyrë të shprehur nëse faktet e paraqitura nga kërkuesja shërbenin në mënyrë të mjaftueshme që barra e provës për diskriminim të kalonte te punëdhënësi, Posta Shqiptare dhe, eventualisht, ky i fundit, të vërtetonte se nuk kishte ndonjë lidhje shkakësore midis gjendjes shoqërore dhe bindjeve politike të kërkueses dhe trajtimit të pafavorshëm të pretenduar prej saj. Ndërkohë, edhe Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur një qëndrim të shprehur në lidhje me të, pavarësisht se shkaku i pretenduar ka natyrë kushtetuese.

42. Për sa më sipër, Gjykata çmon se Gjykata e Lartë, duke mos u dhënë përgjigje pretendimeve të kërkueses, në thelb, ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit të lidhur me parimin e mosdiskriminimit dhe të drejtën për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme. Në vlerësimin e Gjykatës, është detyrë e Gjykatës së Lartë që për shkak të natyrës subsidiare që ka gjykimi kushtetues, të arsyetojë, qoftë në mënyrë të kufizuar, vendimin e saj, në rastet kur pretendimet e ngritura në rekurs kanë të bëjnë me cenimin e parimeve kushtetuese, të cilat gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, pra për ato pretendime kushtetuese që nuk duken se janë haptazi të pabazuara.

43. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses janë të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja

"i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-3578, datë 7.12.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 12.3.2024.
Shpallur, më 11.4.2024.

Kryetare (kundër): Holta Zaçaj
Anëtarë: Fiona Papajorgji, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini
Anëtar kundër: Elsa Toska, Ilir Toska, Genti Ibrahimi

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes nr. 14 (E) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket kërkueses Elisabeta Cara, me objekt: "*Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-3578, datë 7.12.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*", jemi kundër qëndrimit të shumicës, pasi vlerësojmë se kërkesa duhej të ishte rrëzuar për shkak se kërkuesja nuk legjitimohej për vënien në lëvizje të Gjykatës, në kushtet kur ajo nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion përpara se t'i drejtohej asaj për pretendimin e cenimit të parimit të mosdiskriminimit për shkaqe të bindjeve politike dhe gjendjes shoqërore. Për këtë arsye, çmojmë të shprehemi me mendim pakice.

2. Sipas nenit 131, shkronja "f", të Kushtetutës parashikohet se "*Gjykata Kushtetuese vendos për: f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë*". Ky parashikim gjendet i materializuar edhe në përmbajtjen e nenit 71/a, shkronja "a", të ligjit nr. 8577/2000, i cili përcakton se: "*Ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese kur: a) kërkuesi ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive para se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese ose kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete juridike efektive në dispozicion.*".

3. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se, sipas neneve 131, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, individi mund t'i drejtohet asaj me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Qëllimi i këtij neni të Kushtetutës është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatë. Kjo nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili përpara se t'i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura *(shih vendimet nr. 11, datë 21.4.2022; nr. 31, datë 4.10.2021; nr. 38, datë 25.4.2017 të Gjykatës Kushtetuese)*. Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar se, në thelb, rregulli për shterimin e mjeteve juridike përpara se t'i drejtohen Gjykatës me ankim kushtetues synon t'u japë organeve publike dhe, në veçanti, gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, mundësinë të parandalojnë ose korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit. Ana tjetër e rregullit të shterimit të mjeteve juridike përfshin detyrimin e vetë individit që të tregojë kujdesin dhe vëmendjen e duhur për të paraqitur kërkesa, kundërshtime ose ankime tek organet publike dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për rrethanat që mbështesin pretendimet për cenimin e të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 10, datë 7.3.2023; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata ka theksuar se objekti dhe shkaqet e kërkesës, me të cilat ngrihet çështja e kushtetutshmërisë, përbëjnë thelbin (*thema decidendum*) e gjykimit kushtetues *(shih vendimin nr. 22, datë 11.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese)*.

4. Në vlerësimin tonë, çështja në shqyrtim duhej të ishte analizuar bazuar në standardet e mësipërme,

mbështetur në të cilët arrijmë në konkluzionin se kërkesa e kërkueses duhej të rrëzohej.

5. Konkretisht, referuar rrethanave të çështjes, në mënyrë të përmbledhur, ka rezultuar se kërkuesja ka ushtruar detyrën e shpërndarëses pranë Postës Shqiptare sh.a., Filiali Fier deri më datë 13.3.2014, kur ndaj saj është dhënë masa disiplinore e largimit nga detyra për shkak të konstatimit të mangësive në punë, bazuar në Kodin e Punës dhe kontratën kolektive të punës.

6. Ndërprerjen e marrëdhënieve të punës kërkuesja e ka kundërshtuar në gjykatë me padi me objekt detyrimin e punëdhënësit për dëmshpërblimin me 17 paga mujore, për: (i) mosres-pektimin e afateve të njoftimit; (ii) mosrespektimin e procedurave të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës; (iii) zgjidhjen e menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuara të marrëdhënieve të punës; si dhe (iv) detyrimin për shpërblim për vjetërsi në punë, sipas përcaktimeve të neneve 143, 144, 145, 155, pikat 1 dhe 3, të Kodit të Punës. Si shkak ligjor të padisë kërkuesja ka përcaktuar zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustifikuar të kontratës së punës, duke pretenduar se ka përmbushur detyrimet kontraktuale dhe se shpeshherë është vlerësuar nga eprorët si shembull për të tjerët.

7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin e datës 14.1.2015 ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se kontrata ishte zgjidhur në mënyrë të menjëhershme dhe për shkaqe të justifikuara në përputhje me përcaktimet e Kodit të Punës. Sipas gjykatës, kërkuesja ka vepruar me faj të rëndë, duke mos zbatuar detyrimet e saj kontraktuale, pasi, në cilësinë e punëmarrëses, nuk ka ofruar shërbimin për punëdhënësin, madje i ka krijuar atij vështirësi të dukshme në procesin e shërbimit postar te destinatari, veprimtari për të cilën ai duhet të jetë konkurrent në treg si shoqëri publike. Po sipas gjykatës, ishte pikërisht sjellja jo korrekte e paditëses në punë, që me faj të rëndë në formën e neglizhencës, ka çuar punëdhënësin në zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës dhe se qëndrimi i tij gjendet i bazuar në parashikimet e neneve 153 dhe 154 të Kodit të Punës, si dhe të nenit 18, shkronja "b", të marrëveshjes kolektive të punës të datës 15.3.2011.

8. Kundër këtij vendimi kërkuesja ka ushtruar ankim, në përmbajtje të të cilit ka parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, se gjykata e shkallës së parë ka bërë interpretim dhe zbatim të gabuar të ligjit material dhe se vendimi është në kundërshtim me provat e administruara. Sipas kërkueses, gjykata i ka marrë të mirëqena prapësimet e punëdhënësit pa bërë një hetim gjyqësor të gjithanshëm. Masat disiplinore të dhëna nga punëdhënësi gjatë vazhdimit të marrëdhënieve të punës nuk i janë komunikuar asnjëherë dhe se punëdhënësi nuk ka paraqitur prova për të bindur gjykatën se sa ishte në përqindje ngarkesa e punës që ajo duhej të përballonte dhe në çfarë mase nuk është realizuar. Po sipas kërkueses, ngarkimi i një detyre jashtë kapacitetit njerëzor përbën diskriminim të punëmarrësit dhe vënien në pozita inferiore, duke shfrytëzuar nevojën e tij për punë. Largimi nga puna për mospërmbushje të një detyre kur ajo është objektivisht e pamundur të përmbushet brenda një afati të caktuar, nënkupton keqbesimin e punëdhënësit në marrëdhënien e punës.

9. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin e datës 14.7.2015 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke ndjekur të njëjtën linjë arsyetimi me të. Sipas gjykatës së apelit, nga tërësia e akteve të administruar në gjykim, rrethanat e faktit, si dhe nga analiza në vazhdimësi e veprimeve të kërkueses, është provuar se ajo nuk ka zbatuar detyrat në zonën që ka kryer shërbimin e shpërndarëses së postës. Veprimet jo të ligjshme të kërkueses bëjnë që masa disiplinore e largimit nga detyra të jetë e bazuar dhe, për rrjedhojë, vendimi i gjykatës së shkallës së parë të jetë i bazuar në ligj dhe në prova.

10. Në rekursin e ushtruar në Gjykatën e Lartë, kërkuesja ka parashtruar se: (i) dy gjykatat më të ulëta kanë zbatuar keq ligjin; (ii) nuk kanë respektuar kërkesat e nenit 153 të Kodit të Punës për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së paditëses për shkaqe të justifikuara, pasi e kanë vlerësuar vendimin për thyerjen e disiplinës së rëndë për shkak të rëndësisë së veçantë që kishte pjesëmarrja e saj në shpërndarjen e postës; (iii) nuk kanë hetuar nëse ekzistojnë shkaqet e justifikuara të zgjidhjes së kontratës së punës; (iv) nuk kanë arsyetuar se cilën pikë të rregullores së punës ka shkelur ose ka përmendur se ka pasur ankesa, por nuk ka evidentuar asnjë rast që persona fizikë e juridikë të jenë ankuar që korrespodenca e tyre të mos ketë shkuar në destinacion; (v) çdo objekt postar ajo e ka pasqyruar në librin përkatës të postës dhe punëdhënësi nuk ka provuar që ajo nuk ka çuar në destinacion objektin postar, pra nuk është provuar

që ajo të ketë humbur, zhdukur ose të ketë dorëzuar me vonesë një objekt postar të rëndësisë së veçantë; (vi) ankimi i saj lidhur me ngarkesën në punë në shpërndarjen e faturave nuk ka përse të konsiderohet dhe të interpretohet sikur ajo ka shkelur disiplinën në punë, por ka qenë ankesë për ndihmë që këto fatura të bëheshin sa më shpejt, pasi në këtë periudhë ato kanë qenë masive, për shkak të masave që mori qeveria në likuidimin e faturave të energjisë elektrike.

11. Gjykata e Lartë, me vendimin e datës 7.12.2022 ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 472 të KPC-së. Sipas saj, gjykatat më të ulëta kanë respektuar ligjin material duke e interpretuar dhe zbatuar drejtë atë dhe se vendimet e tyre nuk janë në kundërshtim me ndonjë vendim të Gjykatës së Lartë, ndërsa pjesa e pretendimeve që ngre çështje të vlerësimit të provave, del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të saj.

12. Ky vendim është kundërshtuar nga kërkuesja me ankim kushtetues individual, e cila, ndër të tjera, ka pretenduar se shkaqet e vërteta për zgjidhjen e kontratës së punës kanë qenë ato me natyrë diskriminuese, pasi ajo është praktikante e fesë myslimane, e persekutuar politike dhe e orientuar me ide politike të djathta. Ky fakt, sipas kërkueses, vërtetohet me shkresën e datës 20.11.2018, të Ministrisë së Brendshme, përmes së cilës asaj i është njohur koha e dëbimit nga Tirana në Fier, nga data 12.2.1966 deri më datë 29.6.1990, për çështje politike.

13. Në vijim të shqyrtimit të ankimit kushtetues, shumica ka vlerësuar se kërkuesja ka kundërshtuar në gjykatë zgjidhjen e kontratës së punës për shkaqe të pajustifikuara, të cilat nuk i ka specifikuar në aktin e padisë, por gjatë gjykimit, ajo ka përmendur, si të tilla, edhe ato me natyrë diskriminuese të lidhura me bindjet politike dhe përkatësinë shoqërore të saj; ky pretendim është prapësuar në gjykim në shkallë të parë edhe nga subjekti i interesuar dhe është pasqyruar në vendimin përfundimtar të gjykatës së shkallës së parë; në apel dhe rekurs kërkuesja ka kundërshtuar zgjidhjen e kontratës sërish për shkaqe të pajustifikuara, të cilat, referuar akteve në gjykim, përfshinin edhe ato për diskriminim. Në këtë situatë, shumica, ka çmuar se kërkuesja ka shteruar mjetet ligjore në dispozicion për këtë pretendim (*shih paragrafin 14 të vendimit*). Në vijim, shumica e ka analizuar çështjen në këndvështrim të standardit të arsyetimit të vendimit të lidhur me parimin e mosdiskriminimit dhe me të drejtën për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme, sipas neneve 18, 42 dhe 49 të Kushtetutës (*shih paragrafin 23 të vendimit*). Në përfundim, shumica ka arsyetuar se gjykatat kishin detyrimin të verifikonin pretendimin e kërkueses dhe t'i jepnin përgjigje të arsyetuar, ndërkohë që edhe Gjykata e Lartë, duke mos u dhënë përgjigje pretendimeve të kërkueses, në thelb, ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit të lidhur me parimin e mosdiskriminimit dhe të drejtën për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme (*shih paragrafët 41 dhe 42 të vendimit*).

14. Përkundër vlerësimit të shumicës, sikurse rezulton edhe nga pasqyrimi i detajuar i përmbajtjes së padisë, ankimit dhe rekursit (*shih paragrafët 6, 8 dhe 10 më sipër*), kërkuesja nuk ka pretenduar në aktet me shkrim drejtuar të tria gjykatave të juridiksionit të zakonshëm se shkak për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës ka qenë diskriminimi për arsye të përkatësisë politike dhe shoqërore. Ndonëse në procesverbalet e mbajtura nga punëdhënësi dhe në procesin përpara gjykatës së shkallës së parë kërkuesja e ka përmendur faktin se procesi administrativ ndaj saj është bërë për arsye politike, konstatohet se ajo nuk e ka kërkuar ose argumentuar atë as gjatë gjykimit në shkallë të parë, as gjatë gjykimit në apel, dhe as gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë (*shih paragrafët 7, 9 dhe 11 më sipër*). Shkaqet e paraqitura nga kërkuesja në të tria aktet, nëpërmjet të cilave ajo ka vënë në lëvizje procesin gjyqësor në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, lidheshin me faktin se punëdhënësi ka zgjidhur kontratën e punës në mënyrë të menjëhershme, të pajustifikuar, ndërsa ajo ka kryer detyrat e ngarkuara me korrektësi. Për më tepër, në asnjë prej akteve të paraqitura (padi, ankim, rekurs), kërkuesja nuk ka referuar, qoftë edhe formalisht, nenin 146 të Kodit të Punës, i cili rregullon zgjidhjen e kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme ose për shkaqe abuzive, ku, si i tillë, përcaktohet edhe kur punëdhënësi shkel ndalimin e diskriminimit, sipas përcaktimeve në këtë kod dhe në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi (*pika 1, shkronja "ç"*), gjë e cila e bën zgjidhjen e kontratës së punës të pavlefshme (*pika 3, po aty*). Ndërkohë që çështja e largimit nga puna për shkaqe diskriminuese, sikurse ato me natyrë fetare dhe politike, janë artikuluar dhe pasqyruar me shkrim

dhe qartazi, për herë të parë, vetëm në ankimin kushtetues të paraqitur përpara Gjykatës.

15. Bazuar në faktet e mësipërme që marrin vlerë në një gjykim kushtetues, vlerësojmë se lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të mosdiskriminimit, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive që ka pasur në dispozicion, për rrjedhojë ajo nuk e ka përmbushur këtë kriter të legjitimimit për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues.

16. Në kushtet kur përmbushja e kritereve të legjitimimit është kumulative, shqyrtimi i bazueshmërisë së këtij pretendimi në themel nuk duhej të kishte vijuar. Shumica e ka vlerësuar atë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, megjithëse Gjykata e Lartë duket që u ka dhënë përgjigje shkaqeve të parashtruara në rekursin e kërkueses. Për më tepër, evidentojmë se, sikundër u theksua më lart, kërkuesja nuk i ka orientuar gjykatat e zakonshme drejt faktit se shkaqet për largimin e saj nga puna lidheshin me arsye diskriminuese, prandaj shqyrtimi i pretendimeve të kësaj natyre nga Gjykata nuk do të ishte në përputhje me parimin e subsidiaritetit. Lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, Gjykata ka theksuar se kur është rasti i shqyrtimit nga ana e saj i kërkesave individuale, në bazë të nenit 131, shkronja "f", të Kushtetutës, ajo udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit, pasi një qëndrim i ndryshëm do ta kthente atë në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj *(shih vendimet nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 3, datë 23.2.2016; nr. 62, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese).*

17. Ne, gjyqtarët në pakicë, në nivel parimor të ndarjes së juridiksioneve dhe në respektim të parimit të subsidiaritetit, vlerësojmë se juridiksioni kushtetues nuk duhet t'i mbivendoset atij gjyqësor, i cili, në rastin konkret, në përmbushje të detyrës funksionale ka analizuar provat dhe faktet, si dhe ka zgjidhur çështjen e themelit, mbështetur në pretendimet dhe kërkimet e vetë kërkueses, brenda kuadrit kushtetues dhe ligjor.

18. Për sa më lart, në kuptim të normave kushtetuese, standardeve jurisprudenciale të kësaj Gjykate dhe rrethanave të rastit konkret, çmojmë se vlerësimi i Gjykatës në lidhje me pretendimin e kërkueses për cenimin e parimit të mosdiskriminimit për shkaqe të bindjeve politike dhe gjendjes shoqërore, duhej të ishte ndalur në çështjen e legjitimimit të saj, pa vijuar më tej me bazueshmërinë në themel të këtij pretendimi, ndaj edhe për këtë shkak kërkesa duhej të rrëzohej.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtarë: Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Elsa Toska

VENDIM
Nr. 17, datë 13.3.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Sandër Beci	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datat 15.2.2024 dhe 13.3.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 13 (M) 2023 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Mimoza Margjeka, përfaqësuar nga avokate Margarita Kola, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga prokurorët Sotir Kllapi dhe Enkeleda Millonai.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 457, datë 21.10.2022, të Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; nr. 171, datë 9.11.2022, të Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; nr. 00-2023-8, datë 12.1.2023, të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 27, 28, pika 3 dhe 42, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkueses, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Mimoza Margjeka është proceduar nga Prokuroria e Posaçme në kuadër të procedimit penal nr. 186, datë 9.7.2020 (*procedimi penal nr. 186/2020*) për veprën penale "Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë", të parashikuar nga nenet 319/ç dhe 25 të Kodit Penal (*KP*).

2. Mbi bazën e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO e Shkallës së Parë*), me vendimin nr. 92, datë 5.9.2020, ka vendosur caktimin e masës së sigurimit personal "Arresti në shtëpi", të parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*). Masa është zbatuar në datën 9.9.2020. Po ajo gjykatë, me vendimin nr. 94, datë 12.9.2020, ka vendosur vazhdimin e zbatimit të masës. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkuesja.

3. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO e Apelit*), me vendimin nr. 29, datë 1.10.2020, ka vendosur miratimin e vendimeve nr. 92, datë 5.9.2020 dhe 94, datë 12.9.2020 të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Ndërsa rekursi i ushtruar nga kërkuesja kundër këtij vendimi nuk është pranuar nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. 00-2020-486, datë 24.12.2020.

4. Në vijim, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, pasi është njohur me informacionin e prokurorit për hetimet e kryera për procedimin penal nr. 186/2020, në zbatim të nenit 246, pika 6, të KPP-së, me vendimin nr. 403, datë 24.11.2020, ka vendosur zëvendësimin e masës së sigurimit për kërkuesen në "Detyrim për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore". Ky vendim është ndryshuar nga GJKKO-ja e Apelit me vendimin nr. 221, datë 17.12.2020 dhe kërkuesja ka vazhduar nën masën e sigurimit personal "Arresti në shtëpi".

5. Në datën 26.2.2021 Prokuroria e Posaçme ka dërguar kërkesën për kalimin e çështjes në gjyq. Kërkesa është pranuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë me vendimin nr. 37, datë 7.5.2021.

6. Gjatë kohës që çështja ka qenë në proces gjykimi, kërkuesja, në datën 19.10.2022, mbështetur në nenin 263, pika 2, shkronja "b", të KPP-së, ka kërkuar shuarjen e masës së sigurimit personal, me argumentin se është tejkaluar afati i zbatimit të saj. Kërkesa është rrëzuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 457, datë 21.10.2022, me arsyetimin se masa e sigurimit personal "Arresti në shtëpi" është e ndryshme nga ajo "Arresti në burg" dhe në zbatim të nenit 263, pika 2, shkronja "b", të lidhur me nenin 267, pika 1, të KPP-së për atë masë zbatohet dyfishi i afateve të parashikuara nga neni 263 i KPP-së. Në rastin konkret, sipas gjykatës, afati është 18 muaj, i cili ende nuk është përmbushur, ndaj masa nuk e ka humbur fuqinë e saj.

7. Mbi bazën e ankimit të kërkueses, GJKKO-ja e Apelit, me vendimin nr. 171, datë 9.11.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me të njëjtën linjë arsyetimi. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesja, i cili është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 13.12.2022.

8. Gjatë kohës që rekursi ishte në pritje për shqyrtim, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 69, datë 15.12.2022, ka vendosur deklarimin fajtore të kërkueses sipas akuzës dhe dënimin e saj. Në pikën 14 të dispozitivit, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, në zbatim të nenit 261, pika 1, shkronja "b", të KPP-së, ka disponuar shuarjen e masës së sigurimit personal "Arresti në shtëpi". Ky vendim është lënë në fuqi nga GJKKO-ja e Apelit me vendimin nr. 52, datë 12.12.2023.

9. Ndërkohë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim rekursin për shuarjen e masës së sigurimit personal, me vendimin nr. 00-2023-8, datë 12.1.2023, ka vendosur mospranimin e tij me arsyetimin se çështja ka mbetur pa objekt, pasi masa e sigurimit personal nuk është më në fuqi, për shkak se ndaj kërkueses është disponuar me vendim penal të formës së prerë për dënimin e saj.

10. Në datën 9.5.2023 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit. Kolegji i Gjykatës në datën 7.7.2023 ka vendosur kalimin e

çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, ndërsa kjo e fundit në datën 14.7.2023 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Fillimisht, seanca plenare për shqyrtimin e çështjes u caktua në datën 15.2.2024, por për arsye objektive zhvillimi i saj u shty për datën 13.3.2024, ndryshim për të cilin palët janë njoftuar rregullisht.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. ***Kërkuesja,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet objekt kundërshtimi i kanë cenuar:

11.1. *Lirinë personale*, të garantuar nga nenet 27 dhe 17 të Kushtetutës, pasi në zbatim të gabuar të ligjit procedural penal asaj i është kufizuar liria tej afateve ligjore, pasojat e të cilit janë shtrirë edhe te familjarët e saj, në kushtet kur edhe bashkëshorti është proceduar me të njëjtën masë për efekt të të njëjtit procedim, situatë kjo që ka ndikuar te vajza e saj e mitur. Sipas saj, afati i masës së sigurimit personal ka qenë 9 muaj, pasi vepra penale për të cilën ajo është akuzuar parashikon dënimin me burgim deri në 10 vjet. Ndërkohë që afati i llogaritur prej saj nga data 26.2.2021 deri në datën 19.10.2022, ditën e paraqitjes së kërkesës, është 386 ditë, duke mos llogaritur afatet e pezulluara të paraburgimit.

11.2. *Të drejtën për një proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të *së drejtës së aksesit në aspektin substancial*, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit për shkak se çështja ka mbetur pa objekt, ndërkohë ai ka pasur objekt dhe lidhej me paligjshmërinë e vendimeve të dy gjykatave më të ulëta për rrëzimin e kërkesën e saj për shuarjen e masës së sigurimit personal si rezultat i përfundimit të afatit 9-mujor, në zbatim të nenit 263, paragrafi i dytë, shkronja "b", të KPP-së. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë i ka mohuar asaj të drejtën për t'u gjykuar. Për më tepër që kjo çështje ka rëndësi për njësimin e praktikës gjyqësore, pasi në vendime të ndryshme të kolegjeve penale të Gjykatës së Lartë janë mbajtur qëndrime të ndryshme në lidhje me llogaritjen e afateve të masës së sigurimit "Arresti në shtëpi". Po kështu, kjo e drejtë është cenuar edhe për shkak të mosshuarjes së masës së sigurimit në kundërshtim me ligjin.

12. ***Subjekti i interesuar,*** Prokuroria e Posaçme, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

12.1. Pretendimi i kërkueses se afatet e masës së sigurimit personal "Arresti në shtëpi" përllogariten njësoj me masën e sigurimit "Arresti në burg" nuk qëndron, pasi tashmë ekziston një praktikë e konsoliduar që ndonëse këto masa shtrënguese kufizojnë në mënyrë të ngushtë lirinë e personit, ato ndryshojnë nga njëra – tjetra si për sa u përket kritereve për t'u caktuar, ashtu dhe vendit e kushteve në të cilat ekzekutohen. Dallimi ndërmjet këtyre dy masave qëndron edhe për faktin se njëra i drejtohet të pandehurit (arresti në shtëpi), ndërsa tjetra Policisë Gjyqësore (arresti në burg), afati i së parës fillon në çastin që njoftohet vendimi, ndërsa i së dytës nga çasti i arrestimit ose ndalimit. Gjithashtu, njoftimi i të pandehurve bëhet në mënyra të ndryshme. Nga ana tjetër, vetë legjislatori është kujdesur që të shprehë qartësisht se kur për këto dy masa mund të zbatohen procedura ose afate të njëjta, sikurse në rastin e neneve 236 dhe 248 të KPP-së.

12.2. Pretendimi i kërkueses për *cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor* është i pabazuar, pasi parë në aspektin procedural Gjykata e Lartë ka vepruar drejt me mospranimin e rekursit, sepse masa e sigurimit personal nuk ekzistonte më, pasi ishte shuar. Pavarësisht se Gjykata e Lartë nuk ka bërë analizë të detajuar të pretendimeve të ngritura nga kërkuesja në rekurs, kjo nuk e bën vendimin e saj të cenueshëm dhe nuk konstatohet as ndonjë shkelje e së drejtës së kërkueses. Për më tepër, çështja nuk shtron diskutime ligjore dhe arsyetimi i dhënë nga gjykatat më të ulëta ka qenë ezaurues. Kërkuesja ka pasur mundësi t'u drejtohet gjykatave dhe kërkesa e saj është shqyrtuar nga të tria gjykatat, për pasojë asaj nuk i është mohuar e drejta për t'u gjykuar ose për t'iu drejtuar gjykatës.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

13. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së

drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

14. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht.

15. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se kërkuesja ka kundërshtuar procesin gjyqësor të zhvilluar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për kërkesën e saj për shuarjen e masës së sigurimit personal "Arresti në shtëpi". Ndërkohë, në momentin e paraqitjes së ankimit kushtetues (09.5.2023) dhe shqyrtimit të tij nga Gjykata (13.3.2024), masa e sigurimit personal ndaj kërkueses ishte shuar me vendimin e dënimit të datës 15.12.2022 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, të lënë në fuqi nga GJKKO-ja e Apelit me vendimin e datës 12.12.2023.

16. Gjykata thekson se në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, në rastin e ankimeve kushtetuese individuale kërkuesi duhet të provojë legjitimitetin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo do të thotë se individi mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkelje dhe pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të.

17. Në kontekst të rrethanave të rastit në shqyrtim, Gjykata sjell në vëmendje qëndrimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) në çështjen Hysa kundër Shqipërisë, datë 21.2.2023, sipas së cilës *"ndonëse në datën kur Gjykata Kushtetuese mori vendimin e saj, kërkuesja kishte vuajtur tashmë kufizimin e lirisë së saj, ajo mund të përfitonte në mënyrë legjitime nga një shqyrtim kushtetues post facto dhe se një shqyrtim i plotë nga Gjykata Kushtetuese mund të kishte çuar në konstatimin se kërkuesja ishte mbajtur në burgim në shkelje të së drejtës së saj për liri." (shih Hysa kundër Shqipërisë, datë 21.2.2023, § 83).*

18. Në këndvështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se ka detyrimin të shqyrtojë rastin e kufizimit të lirisë personale, pavarësisht faktit nëse kërkuesja në kohën e shqyrtimit të çështjes ndodhej në kushtet e kufizimit të kësaj lirie ose jo. Për rrjedhojë, kërkuesja legjitimohet *ratione personae*, pasi ka interes të drejtpërdrejtë për çështjen e parashtruar, në zbatim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës.

19. Për sa i takon kriterit për *shterimin e mjeteve juridike efektive*, individi mund t'i drejtohet Gjykatës me ankim individual kushtetues, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Detyrimin për përmbushjen e këtij kriteri Gjykata e ka vlerësuar si në rastet e vendimeve përfundimtare, që kanë përmbyllur në themel procesin gjyqësor, ashtu edhe në rastin e vendimeve të ndërmjetme, karakteri i të cilave është konsideruar përfundimtar për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës. Për sa u takon këtyre të fundit, Gjykata ka pranuar se vendimet gjyqësore për caktimin e masës të sigurimit personal me karakter shtrëngues që lidhet me heqjen e lirisë së individit, si përjashtim, e bëjnë atë një vendim përfundimtar në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 19, datë 4.4.2023; nr. 14, datë 11.3.2021; nr. 28, datë 23.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata çmon se kërkuesja ka paraqitur ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta për kërkesën e saj për shuarjen e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arresti në shtëpi". Për rrjedhojë ajo i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion para se t'i drejtohet Gjykatës, pasi nuk ka më mjete të tjera ankimi ndaj vendimit të Gjykatës së Lartë.

21. Gjithashtu, kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis,* pasi vendimi më i fundit gjyqësor i kundërshtuar prej saj është dhënë në datën 12.1.2023, ndërsa ankimi kushtetues është paraqitur në datën 9.5.2023, pra brenda afatit 4 - mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000.

22. Lidhur me legjitimimin *ratione materiae*, kërkuesja ka kundërshtuar vendimet e gjykatave të zakonshme që kanë shqyrtuar kërkesën e saj për shuarjen e masës së sigurimit personal "Arresti në shtëpi", me pretendimin se ato i kanë cenuar lirinë personale dhe të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit, të garantuara nga nenet 27 dhe 42 të Kushtetutës. Sipas kërkueses, Gjykata e Lartë, me arsyetimin se çështja ka mbetur pa objekt, pasi masa e sigurimit është shuar me vendimin e themelit për dënimin e saj, nuk e ka pranuar rekursin. Përkundër këtij pretendimi, subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se Gjykata e Lartë ka vepruar drejt me mospranimin e rekursit, pasi masa e sigurimit personal ishte shuar.

23. Gjykata vë në dukje se sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja "ç", të ligjit nr. 8577/2000, kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë dhe kur shqyrtimi i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur.

24. Në këtë drejtim, Gjykata thekson rëndësinë e veçantë që merr liria personale si një e drejtë themelore kushtetuese dhe substanciale, e cila nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 12, datë 24.5.2022; nr. 40, datë 18.7.2012, të Gjykatës Kushtetuese*), si dhe mundësinë që ka kushdo për të gëzuar të drejtën për kompensim për burgim të padrejtë edhe në rastin e vuajtjes së arrestit në shtëpi tej afateve të përcaktuara nga ligji. Lidhur me këtë GJEDNJ-ja, në rastin e shqyrtimit të pretendimeve për parregullsi të procesit gjyqësor që ka sjellë kufizim të padrejtë të lirisë, është shprehur se *"përveç interesit moral në marrjen e rezultatit, një ndihmë e tillë deklarative mund të hapte rrugën edhe për një kërkesë për kompensim mbi arsyet për burgim të paligjshëm sipas nenit 5 § 5 të Konventës (shih Hysa kundër Shqipërisë, datë 21.2.2023, § 83).*

25. Për sa më lart, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë thelbin e argumenteve të kërkueses, vlerëson t'i analizojë pretendimet e saj në këndvështrim të së drejtës së aksesit të lidhur me kufizimin e lirisë personale, të cilat hyjnë në juridiksionin kushtetues të saj.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me kufizimin e lirisë personale

26. Kërkuesja ka pretenduar se në zbatim të gabuar të ligjit procedural penal asaj i është kufizuar liria tej afateve ligjore, pasojat e të cilit janë shtrirë edhe te familjarët e saj, në kushtet kur edhe bashkëshorti është proceduar me të njëjtën masë për efekt të të njëjtit procedim, situatë kjo që ka ndikuar te vajza e saj e mitur. Sipas saj, afati i masës së sigurimit personal ka qenë 9 muaj, pasi vepra penale për të cilën ajo është akuzuar parashikon dënimin me burgim deri në 10 vjet. Ndërkohë që afati i llogaritur prej saj nga data 26.2.2021 deri në datën 19.10.2022, ditën e paraqitjes së kërkesës, është 386 ditë, duke mos llogaritur afatet e pezulluara të paraburgimit. Sipas saj, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit për shkak se çështja ka mbetur pa objekt, ndërkohë ai ka pasur objekt dhe lidhej me paligjshmërinë e vendimeve të dy gjykatave më të ulëta për rrëzimin e kërkesën e saj për shuarjen e masës së sigurimit personal si rezultat i përfundimit të afatit 9-mujor, në zbatim të nenit 263, paragrafi i dytë, shkronja "b", të KPP-së. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë i ka mohuar asaj të drejtën për t'u gjykuar. Për më tepër që kjo çështje ka rëndësi për njësimin e praktikës gjyqësore, pasi në vendime të ndryshme të kolegjeve penale të Gjykatës së Lartë janë mbajtur qëndrime të ndryshme në lidhje me llogaritjen e afateve të masës së sigurimit "Arresti në shtëpi".

27. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se pretendimi i kërkueses nuk qëndron, pasi tashmë ekziston një praktikë e konsoliduar, që ndonëse këto masa shtrënguese kufizojnë në mënyrë të ngushtë lirinë e personit, ato ndryshojnë nga njëra-tjetra si për sa u përket kritereve për t'u caktuar, ashtu dhe vendit e kushteve në të cilat ekzekutohen. Nga ana tjetër, vetë legjislatori është kujdesur të shprehë qartësisht se kur për këto dy masa mund të zbatohen procedura ose afate të njëjta, sikurse në rastin e neneve 236 dhe 248 të KPP-së. Sipas tij, parë në aspektin procedural, Gjykata e Lartë ka vepruar drejt me mospranimin e rekursit, pasi masa e sigurimit personal nuk ekzistonte më sepse ishte shuar. Pavarësisht se Gjykata e Lartë nuk ka bërë analizë të detajuar të pretendimeve të ngritura nga kërkuesja në rekurs, kjo nuk e bën vendimin e saj të cenueshëm dhe nuk konstatohet as ndonjë shkelje e së drejtës së kërkueses. Për më tepër, çështja nuk shtron diskutime ligjore dhe arsyetimi i dhënë nga gjykatat më të ulëta ka qenë ezaurues, ndërsa kërkuesja ka

pasur mundësi t'u drejtohet gjykatave dhe kërkesa është shqyrtuar nga të tria gjykatat, për pasojë asaj nuk i është mohuar e drejta për t'u gjykuar ose për t'iu drejtuar gjykatës.

28. Kushtetuta në nenin 42 ka parashikuar se liria nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor (*pika 1*) dhe se kushdo, për mbrojtjen e saj, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë (*pika 2*). Ndërsa në nenin 27 ajo ka sanksionuar se liria nuk mund t'i hiqet askujt, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj (*pika 1*) dhe se kufizimi i saj mund të bëhet vetëm kur ka dyshime të arsyeshme se individi ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj *(pika 2, shkronja "c", po aty*).

29. Për sa i takon së drejtës së aksesit në gjykatë, Gjykata ka theksuar se kur në rekurs janë ngritur pretendime, të cilat janë të rëndësishme për verifikimin e kushtetutshmërisë së procesit të zhvilluar në gjykatat e zakonshme dhe kërkuesi nuk ka marrë përgjigje për to, për shkak të vendimit të mospranimit të rekursit, kjo përbën cenim të së drejtës themelore për proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Në këtë kuptim, aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 58, datë 13.11.2023; nr. 11, datë 16.4.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Gjithashtu, për sa i përket kufizimit të lirisë personale, Gjykata ka pohuar se organet e pushtetit publik kanë detyrimin të respektojnë të drejtën për proces të rregullt ligjor edhe ndaj personave të cilëve sipas ligjit u është kufizuar liria, pasi, ashtu si të drejtat e tjera, edhe kjo e drejtë është e pandashme, e patjetërsueshme dhe e padhunueshme (*shih vendimin nr. 5, datë 22.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Lidhur me kufizimin e lirisë personale si pasojë e zbatimit të masës së sigurimit "Arresti në shtëpi", GJEDNJ-ja në praktikën e saj gjyqësore është shprehur se kjo masë konsiderohet, për nga shkalla dhe intensiteti i saj, si privim i lirisë në kuptim të nenit 5 të KEDNJ-së *(shih Nikolova kundër Bullgarisë (nr. 2), datë 30.9.2004, § 60; Ninescu kundër Republikës së Moldavisë, datë 15.7.2014, § 53; Delijorgji kundër Shqipërisë, datë 28.4.2015, § 75).* Sipas GJEDNJ-së, është e vërtetë se në shumicën e rasteve arresti në shtëpi nënkupton më pak kufizime dhe një shkallë më të vogël vuajtjeje apo shqetësimi për të pandehurin sesa paraburgimi i zakonshëm në burg. Pavarësisht nga vendi, ndaj kërkuesit zbatohen të njëjta kritere për të gjithë periudhën e kufizimit të lirisë. Po sipas saj, nocionet "shkallë" dhe "intensitet" në praktikën gjyqësore, si kritere për zbatueshmërinë e nenit 5 të KEDNJ-së, i referohen vetëm shkallës së kufizimeve të lirisë së lëvizjes, jo dallimeve në rehati ose në regjimin e brendshëm të paraburgimit *(shih Buzadji kundër Republikës së Moldavisë, datë 5.7.2016, § § 103, 112–114).*

32. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesja në datën 19.10.2022, bazuar në nenin 263, pika 2, shkronja "b", të KPP-së, ka paraqitur kërkesë në gjykatë për shuarjen e masës së sigurimit personal "Arresti në shtëpi", me argumentin se në datën 26.2.2021 janë depozituar në gjykatën e shkallës së parë aktet e procedimit penal nr. 186/2020 dhe prej asaj dite kanë kaluar 12 muaj pa u dhënë vendimi. Sipas kërkueses, vepra penale për të cilën ajo akuzohet është e parashikuar nga neni 319/ç i KP-së, që përcakton masën e dënimit nga tre deri në dhjetë vjet burgim. Në këtë situatë, sipas saj, masa e sigurimit personal e ka humbur fuqinë për shkak të tejkalimit të afatit 9-mujor, duke qenë se shqyrtimi gjyqësor ishte në proces dhe se nga përllogaritja e afateve të gjykimit kanë kaluar pa u dhënë vendimi nga gjykata e shkallës së parë 386 ditë, duke mos llogaritur afatet e pezulluara të paraburgimit.

33. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin e datës 21.10.2022, e ka rrëzuar këtë kërkesë, pasi ka arsyetuar se kërkuesja gjendet në kushtet e masës së sigurimit personal "Arresti në shtëpi", e cila është një masë sigurimi e ndryshme nga ajo e paraburgimit "Arresti në burg" dhe në rastin konkret duhet të plotësohen edhe kushtet e parashikuara nga neni 267, pika 1, i KPP-së. Megjithatë, sipas gjykatës, edhe sikur përllogaritja e afateve të bëhej sipas nenit 263 të KPP-së, sërish masa nuk e humbet fuqinë e saj, pasi nuk rezulton të ketë kaluar afati i kohëzgjatjes tërësore të paraburgimit prej 2 vjetësh, sikurse e parashikon pika 6 e nenit 263 të KPP-së.

34. Kërkuesja e ka kundërshtuar këtë qëndrim në GJKKO-në e Apelit, e cila, me vendimin e datës 9.11.2022, ka argumentuar se afatet e parashikuara në nenin 263 të KPP-së lidhen me rastin e paraburgimit, ndërsa për të gjitha masat e tjerat të sigurimit personal me karakter shtrëngues, përfshirë edhe masën e sigurimit "Arresti në shtëpi", vlen afati

i kohëzgjatjes së tyre sipas parashikimit të nenit 267, pika 1, të KPP-së. Po kështu, ajo ka arsyetuar se është e qartë që në zbatim të nenit 267 të KPP-së afati i secilës masë sigurimi (e ndryshme nga "Arresti në burg") përllogaritet sa dyfishi i kohëzgjatjes së afatit të parashikuar nga neni 263 i KPP-së dhe fillon të ecë për secilën masë më vete nga zbatimi dhe po nga ky moment përllogaritet edhe afati i kohëzgjatjes maksimale të secilës masë.

35. Kundër këtij vendimi kërkuesja ka ushtruar rekurs, duke parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, se gjykatat kanë interpretuar në mënyrë të gabuar ligjin procedural penal, pasi kohëzgjatja e masës së arrestit në shtëpi është e barabartë me kohëzgjatjen e afateve të paraburgimit, pra barazohet me paraburgimin dhe në këto kushte edhe përllogaritja e kohëzgjatjes së këtyre afateve referon në nenin 263 të KPP-së dhe pezullimi i afateve të paraburgimit referon te neni 265 i KPP-së. Sipas kërkueses, gjykatat nuk kanë zbatuar rregullat e neneve 237/4 dhe 263 të KPP-së dhe as vendimet njësuese të vetë Gjykatës së Lartë.

36. Pas shqyrtimit të rekursit, Gjykata e Lartë, me vendimin e datës 12.1.2023, mbështetur në interpretimin e neneve 420 dhe 433 të KPP-së, ka vendosur mospranimin e tij. Në vendimin e saj Gjykata e Lartë ka konstatuar se rekursi është regjistruar në datën 13.12.2022 dhe se kërkuesja ka ngritur pretendime që kanë të bëjnë me interpretimin e gabuar të ligjit procedural penal nga gjykatat e posaçme për shuarjen e masës së sigurimit personal, pasi kanë kaluar afatet ligjore. Në vijim, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se në momentin e shqyrtimit të rekursit masa e sigurimit, për të cilën është kërkuar shuarja, nuk është më në fuqi, për shkak se për procedimin penal ndaj kërkueses gjykata ka disponuar me vendim penal të formës së prerë. Në këto kushte, sipas Gjykatës së Lartë, rekursi nuk ka më objekt, për pasojë ajo ka disponuar mospranimin e tij.

37. Për sa më lart, Gjykata konstaton se kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë me rekurs për të kundërshtuar interpretimin që gjykatat më të ulëta u kanë bërë dispozitave të KPP-së lidhur me kohëzgjatjen e masës së sigurimit "Arresti në shtëpi" për efekt të shuarjes së saj, duke parashtruar pasoja me natyrë kushtetuese. Ndërkohë, rezulton se Gjykata e Lartë ndonëse ka zgjidhur formalisht çështjen, duke vendosur mospranimin e rekursit, ajo nuk ka bërë vlerësim në substancë të shkaqeve të tij, duke u mjaftuar me faktin se masa për të cilën kishte nisur procesi ishte shuar tashmë nga vendimi gjyqësor i dënimit. Pra, Gjykata e Lartë nuk ka bërë vlerësim nëse gjykatat më të ulëta për shkak të interpretimit të ligjit procedural penal i kanë cenuar ose jo lirinë personale kërkueses për periudhën që ajo pretendonte se ka qëndruar përtej afatit të parashikuar nga ligji. Thënë ndryshe, megjithëse Gjykata e Lartë ka konstatuar se pretendimet e kërkueses lidheshin me interpretimin e gabuar të ligjit procedural penal nga gjykatat e posaçme *(shih paragrafin 15 të vendimit të Gjykatës së Lartë),* ajo nuk u ka dhënë përgjigje atyre, duke i lënë të pazgjidhura, në thelb, pasojat që kishin të bënin me një të drejtë themelore kushtetuese sikurse është kufizimi i lirisë personale.

38. Në kontekst të sa më sipër, Gjykata rithekson se dispozitat e KPP-së nuk mund të interpretohen nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në mënyrë të ngushtë, të atillë që cenon thelbin e së drejtës së një individi për t'iu drejtuar asaj gjykate (*shih vendimin nr. 5, datë 2.3.2011, të Gjykatës Kushtetuese*) dhe se të drejtat individuale duhet të interpretohen gjithmonë në atë mënyrë që të jenë efektive (*shih vendimin nr. 13, datë 7.3.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Nga ana tjetër, Gjykata konstaton se qasja e Gjykatës së Lartë në rastin konkret nuk është në koherencë as me qëndrimin e shprehur prej asaj vetë në vendimin njësues për praktikën gjyqësore nr. 00-2021-1134 (62), datë 1.11.2021, ku, ndër të tjera, ka pohuar se në rastin e rekurseve në lëndë të masave të sigurimit, shqyrtimi i tyre lidhet ngushtësisht me pretendimet për shkelje të ligjit, pasi juridiksioni rishikues i Gjykatës së Lartë nënkupton shqyrtimin e rekurseve për shkelje të ligjit material dhe procedural, duke siguruar zbatimin uniform të ligjit ose zhvillimin e praktikës gjyqësore (*shih paragrafët 44 dhe 45 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

40. Për sa më lart, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë edhe rolin subsidiar të saj në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, vlerëson se Gjykata e Lartë duke mos kontrolluar ligjshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave të faktit, ndonëse është ndodhur para pretendimeve për interpretim të gabuar të ligjit prej tyre, ka cenuar të drejtën e kërkueses për proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me kufizimin e lirisë personale gjatë gjykimit të rekursit është i bazuar.

41. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses janë të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-8, datë 12.1.2023, të Gjykatës së Lartë.
3. Dërgimin për shqyrtim pranë Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 13.3.2024.
Shpallur më 12.4.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Elsa Toska, Sandër Beci, Marjana Semini, Genti Ibrahimi

VENDIM
Nr. 21, datë 3.4.2024

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE PËR TRANSFERTAT E KREDITIT DHE TË DEBITIMIT DIREKT NË EURO

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja "b", nenit 21 dhe nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; nenit 129 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 15, pika 1, të ligjit nr. 133, datë 30.4.2013, "Për sistemin e pagesave"; dhe titujve III, IV dhe V të ligjit nr. 55, datë 30.4.2020, "Për shërbimet e pagesave"; me propozimin e Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Për përcaktimin e kërkesave për transfertat e kreditit dhe të debitimit direkt në euro", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen ofruesit e shërbimeve të pagesave përcaktuar në nenin 3, pika 2, të ligjit nr. 55, datë 30.4.2020, "Për shërbimet e pagesave", për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohen Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës dhe Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko

RREGULLORE
PËR PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE PËR TRANSFERTAT E KREDITIT DHE TË DEBITIMIT DIREKT NË EURO

Neni 1
Objekti dhe fusha e zbatimit

1. Kjo Rregullore përcakton kërkesat për transaksionet e transfertave të kreditit dhe të debitimit direkt të kryera në monedhën euro brenda Shqipërisë dhe ndërmjet Shqipërisë dhe zonës SEPA, ku si OSHP-ja e paguesit, ashtu edhe OSHP-ja e përfituesit, janë në Shqipëri ose një nga OSHP-të është në Shqipëri dhe tjetri brenda zonës SEPA, ose i vetmi OSHP i përfshirë në transaksionin e pagesës ndodhet në Shqipëri.
2. Kjo Rregullore zbatohet pa rënë ndesh me kërkesat e legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe rregullat që administrojnë ekzekutimin e

transfertave të kreditit dhe transaksioneve të debitimit direkt në lek.

3. Kjo Rregullore do të zbatohet edhe për transfertat e kreditit dhe debitimet direkte në lek, për aq sa është e mundur nga pikëpamja teknike dhe operacionale.

Neni 2
Përjashtimet

1. Kjo rregullore nuk zbatohet, për:

a) Transaksionet e pagesave të kryera ndërmjet dhe brenda OSHP-ve, duke përfshirë agjentët ose degët e tyre, për llogari të tyre;

b) Transaksionet e pagesave të procesuara dhe të shlyera përmes sistemeve të pagesave me vlerë të madhe, duke përjashtuar transaksionet e pagesave të debitimit direkt, për të cilat paguesi nuk ka kërkuar në mënyrë eksplicite të procesohen nëpërmjet një sistemi pagesash me vlerë të madhe;

c) Transaksionet e pagesave të kryera nëpërmjet një karte pagese ose pajisjeje të ngjashme, duke përfshirë tërheqjet e parave fizike *(cash),* përveç rastit kur karta e pagesës ose një pajisje e ngjashme përdoret vetëm për të gjeneruar informacionin e kërkuar, për të kryer drejtpërdrejt një transfertë krediti ose debitim direkt drejt dhe nga një llogari pagese e identifikuar nëpërmjet BBAN-it ose IBAN-it;

d) Transaksionet e pagesave të kryera me anë të çdo pajisjeje telekomunikacioni, digjitale ose TIK, nëse transaksione të tilla pagese nuk rezultojnë në një transfertë krediti ose debitimi direkt drejt dhe nga një llogari pagese e identifikuar nëpërmjet BBAN-it ose IBAN-it;

e) Transaksionet e dërgesave të parave të përcaktuara në nenin 5, pika 8 të ligjit nr. 55, datë 30.4.2020, "Për shërbimet e pagesave";

f) Transaksionet e pagesave që transferojnë para elektronike, përveç rasteve kur transaksione të tilla rezultojnë në një transfertë krediti ose debitimi direkt drejt dhe nga një llogari pagese e identifikuar nëpërmjet BBAN-it ose IBAN-it.

2. Kur skemat e pagesave bazohen në transaksionet e pagesave me transferta krediti ose debitime direkte, por kanë veçori ose shërbime shtesë opsionale, kjo rregullore zbatohet vetëm për transfertat e kreditit ose debitimeve direkte ku bazohet skema.

Neni 3
Përkufizime

1. Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) "ALL" është monedha kombëtare lek;

b) "BBAN" është një identifikues i numrit të llogarisë së pagesës, i cili identifikon qartë një llogari individuale të pagesës me një OSHP në Shqipëri dhe që mund të përdoret vetëm për transaksionet e pagesave kombëtare, ndërsa e njëjta llogari pagese identifikohet nga IBAN për transaksionet e pagesave ndërkufitare;

c) "BIC" është një kod identifikues biznesi, i cili identifikon qartë një OSHP, elementet e të cilit përcaktohen nga ISO;

d) "Data e shlyerjes" është data në të cilën shlyhen detyrimet në lidhje me transferimin e fondeve ndërmjet OSHP-së së paguesit dhe OSHP-së së përfituesit;

e) "Debitim direkt" do të thotë një shërbim kombëtar ose ndërkufitar SEPA i pagesës për debitimin e llogarisë së pagesës së një paguesi, kur një transaksion pagese fillon nga përfituesi në bazë të pëlqimit të paguesit;

f) "EPC" është Këshilli Evropian i Pagesave;

g) "Financimi i terrorizmit" nënkupton financimin e terrorizmit të përcaktuar në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", të ndryshuar;

h) "IBAN" është një identifikues ndërkombëtar i numrit të llogarisë së pagesës, i cili identifikon qartë një llogari individuale të pagesës, elementet e të cilit përcaktohen nga Organizata Ndërkombëtare për Standardizimin (ISO);

i) "ISO" është Organizata Ndërkombëtare për Standardizim;

j) "Kërkesë për arkëtim" nënkupton një pjesë të një transaksioni debitimi direkt, duke filluar nga inicimi i tij nga përfituesi deri në përfundimin e tij përmes debitimit normal të llogarisë së pagesës së paguesit;

k) "Ligji për shërbimet e pagesave" është ligji nr. 55, datë 30.4.2020, "Për shërbimet e pagesave" dhe/ose çdo ligj ndryshues i tij;

l) "Mandat" nënkupton shprehjen e pëlqimit dhe autorizimit të dhënë nga paguesi ndaj përfituesit dhe (direkt ose indirekt përmes përfituesit) ndaj OSHP-së të paguesit për të lejuar përfituesin të iniciojë një

kërkesë për arkëtim me anë të debitimit të llogarisë së pagesës të specifikuar të paguesit dhe për t'i lejuar OSHP-së së paguesit të veprojë në pajtim me udhëzime të tilla;

m) "OSHP" është një ofrues i shërbimeve të pagesave;

n) "Pagesat SEPA" janë pagesa midis pjesëmarrësve të skemës së SEPA-s në formën e Transfertave të Kreditit SEPA dhe/ose debitimeve direkte SEPA;

o) "Palë referencë" nënkupton një person fizik ose juridik, në emër të të cilit paguesi kryen një pagesë, ose përfituesi përfiton një pagesë;

p) "PSHP" ose "përdorues i shërbimeve të pagesave" është një person fizik ose juridik që përdor shërbimet e pagesave në cilësinë e paguesit ose të përfituesit të pagesave;

q) "SEPA" është zona e unike e pagesave në euro *("the Single Euro Payments Area");*

r) "Sistemi i pagesave me vlerë të madhe" është një sistem pagese, qëllimi kryesor i të cilit është të procesojë, klerojë ose shlyejë transaksione individuale të pagesave me prioritet dhe urgjencë të lartë, dhe kryesisht me shuma të mëdha;

s) "Sistemi i pagesave me vlerë të vogël" nënkupton një sistem pagesash qëllimi kryesor i të cilit është të procesojë, klerojë ose shlyejë transfertat e kreditit ose debitimet direkte, të cilat përgjithësisht grupohen për transmetim dhe janë kryesisht me shuma të vogla dhe me prioritet të ulët, dhe që nuk është një sistem pagesash me vlerë të madhe;

t) "Skema SEPA" çdo skemë e administruar dhe operuar nga EPC;

u) "Skemë pagese" nënkupton një grup të vetëm rregullash, praktikash, standardesh dhe/ose udhëzimesh zbatimi të rënë dakord ndërmjet OSHP-ve për ekzekutimin e transaksioneve të pagesave brenda Shqipërisë dhe në të gjithë zonën e SEPA-s, dhe që është e ndarë nga çdo infrastrukturë ose sistem pagesash që mbështet funksionimin e saj;

v) "Standardi ISO 20022 XML" është një standard për zhvillimin e mesazheve financiare elektronike, siç përcaktohet nga ISO-ja, që përfshin paraqitjen fizike të transaksioneve të pagesave në sintaksën XML, në përputhje me rregullat e biznesit dhe udhëzimet e zbatimit të Shqipërisë ose të skemave të SEPA-s për transaksionet e pagesave që janë objekt i kësaj rregulloreje;

w) "Shtojca I" është shtojca bashkëlidhur kësaj rregulloreje që përcakton kërkesat teknike të aplikuara për transfertat e kreditit dhe debitimet dikerkte në SEPA, krahas nenit 4;

x) "TIK" nënkupton teknologjinë e informacionit dhe komunikimit ("*ICT*");

y) "Transaksion pagese kombëtare" nënkupton një transaksion pagese të iniciuar nga një pagues ose nga një përfitues, ku OSHP-ja e paguesit dhe OSHP-ja e përfituesit janë të vendosur në Shqipëri;

z) "Transfertë krediti" nënkupton një shërbim pagese kombëtar ose ndërkufitar SEPA për kreditimin e llogarisë së pagesës së një përfituesi me një transaksion pagese ose një seri transaksionesh pagese nga llogaria e pagesës së një paguesi nga OSHP-ja që mban llogarinë e pagesës së paguesit, bazuar në një udhëzim dhënë nga paguesi;

aa) "Zona SEPA" nënkupton shtrirjen gjeografike të skemave të SEPA-s, siç përcaktohet nga kriteret e vendosura nga Këshilli Evropian i Pagesave *("EPC").*

2. Përveç sa përcaktuar në pikën 1, termat e tjerë të përdorur në këtë rregullore do të kenë të njëjtin kuptim, siç përcaktohet në ligjin për shërbimet e pagesave.

Neni 4

Kërkesat për transaksionet e transfertave të kreditit dhe të debitimit direkt

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave kryejnë transaksione të transfertave të kreditit dhe të debitimit direkt në përputhje me kërkesat e mëposhtme:

a) duhet të përdorin identifikuesin e llogarisë së pagesave të specifikuar në pikën 1, shkronja "a" të shtojcës I, për identifikimin e llogarive të pagesave, pavarësisht nga vendndodhja e OSHP-së në fjalë;

b) duhet të përdorin formatet e mesazheve të specifikuara në pikën 1, shkronja "b" të shtojcës I, kur transmetojnë transaksione pagese te një OSHP tjetër ose nëpërmjet një sistemi pagesash me vlerë të vogël;

c) duhet të sigurojnë që përdoruesit e shërbimeve të pagesave të përdorin identifikuesin e llogarisë së pagesës të specifikuar në pikën 1, shkronja "a" të shtojcës I, për identifikimin e llogarive të pagesave, pavarësisht nëse OSHP-ja e paguesit dhe OSHP-ja e përfituesit ose e vetmja OSHP në transaksionin e pagesës është në Shqipëri;

d) duhet të sigurojnë që për rastet kur një PSHP që nuk është konsumator ose mikrondërmarrje, inicion ose merr transferta krediti individuale, ose

debitime direkte individuale, të cilat nuk transmetohen individualisht, por janë të grupuara për transmetim, të përdoren formatet e mesazheve të përcaktuara në pikën 1, shkronja "b", të shtojcës I.

2. Pa cenuar pikën 1, shkronja "b", OSHP-të, me kërkesë specifike të një PSHP-je, do të përdorin formatet e mesazheve të përcaktuara në pikën 1, shkronja "b", të shtojcës I, në lidhje me atë PSHP.

3. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të kryejnë transfertë krediti në përputhje me kërkesat e mëposhtme, subjekt i çdo detyrimi të përcaktuar në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale:

a) OSHP-ja e paguesit duhet të sigurojë që paguesi ofron elementet e të dhënave të përcaktuara në pikën 2, shkronja "a", të shtojcës I;

b) OSHP-ja e paguesit duhet t'i japë OSHP-së së përfituesit elementet e të dhënave të përcaktuara në pikën 2, shkronja "b", të shtojcës I;

c) OSHP-ja e përfituesit duhet të sigurojë ose të vërë në dispozicion të përfituesit elementet e të dhënave të përcaktuara në pikën 2, shkronja "d", të shtojcës I.

4. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të kryejnë debitim direkt në përputhje me kërkesat e mëposhtme, subjekt i çdo detyrimi të përcaktuar në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale:

a) OSHP-ja e përfituesit duhet të sigurojë që:

i. përfituesi siguron elementet e të dhënave të specifikuara në pikën 3, shkronja "a", të shtojcës I në debitimin e parë direkt dhe në debitimin direkt të vetëm, si dhe në çdo transaksion pagese të njëpasnjëshëm;

ii. paguesi jep pëlqimin si për përfituesin, ashtu edhe për OSHP-në e paguesit (direkt ose indirekt nëpërmjet përfituesit), që mandatet, së bashku me ndryshimet ose anulimet e mëvonshme, të ruhen nga përfituesi ose nga një palë e tretë në emër të përfituesit dhe përfituesi vihet në dijeni për këtë detyrim nga OSHP-ja, në përputhje me nenet 44 dhe 45 të ligjit për shërbimet e pagesave;

b) OSHP-ja e përfituesit duhet t'i sigurojë OSHP-së së paguesit elementet e të dhënave të përcaktuara në pikën 3, shkronja "b" të shtojcës I;

c) OSHP-ja e paguesit duhet të sigurojë ose të vërë në dispozicion të paguesit elementet e të dhënave të përcaktuara në pikën 3, shkronja "c" të shtojcës I;

d) Paguesi duhet të ketë të drejtën të udhëzojë OSHP-në e tij:

i. të kufizojë arkëtimin e debitimit direkt në një shumë ose periodicitet të caktuar ose të dyja;

ii. kur një mandat sipas një skeme pagese nuk parashikon të drejtën e rimbursimit, të verifikojë çdo transaksion të debitimit direkt dhe të kontrollojë nëse shuma dhe periodiciteti i transaksionit të debitimit direkt është e barabartë me shumën dhe periodicitetin e rënë dakord në mandat, përpara debitimit të llogarisë së tij të pagesave, dhe bazuar në informacionin e mandatit;

iii. të bllokojë çdo debitim direkt në llogarinë e pagesave të paguesit ose të bllokojë çdo debitim direkt të iniciuar nga një ose më shumë përfitues të specifikuar ose të autorizojë debitime direkte të iniciuara vetëm nga një ose më shumë përfitues të specifikuar.

e) Kur as paguesi dhe as përfituesi i pagesës nuk janë konsumator, OSHP-ve nuk u kërkohet të respektojnë pikën 4, shkronjën "d", paragrafi (i), (ii) ose (iii) të këtij neni;

f) OSHP-ja e paguesit do të informojë paguesin për të drejtat e përmendura në pikën 4, shkronja "d" të këtij neni, në përputhje me nenet 44 dhe 45 të ligjit për shërbimet e pagesave;

g) Me transaksionin e parë të debitimit direkt ose një transaksion të vetëm të debitimit direkt, dhe pas çdo transaksioni të njëpasnjëshëm të debitimit direkt, përfituesi do t'i dërgojë informacionin lidhur me mandatin OSHP-së së tij dhe OSHP-ja e përfituesit do ta transmetojë informacionin, në lidhje me mandatin tek OSHP-ja e paguesit, në çdo transaksion të debitimit direkt.

5. Përveç kërkesave të përmendura në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, përfituesi që pranon transfertat e kreditit duhet t'u komunikojë paguesve të tij identifikuesin e llogarisë së tij të pagesës të specifikuar në pikën 1, shkronja "a" të shtojcës I, kur kërkohet një transfertë krediti.

6. Përpara transaksioneve të para të debitimit direkt, paguesi duhet të komunikojë identifikuesin e llogarisë së tij të pagesës të specifikuar në pikën 1, shkronja "a" të shtojcës I.

7. Kur marrëveshja kuadër ndërmjet paguesit dhe OSHP-së së paguesit nuk parashikon të drejtën e rimbursimit, OSHP-ja e paguesit, pa cenuar pikën 4, shkronja "a", paragrafi "ii" i këtij neni, do të verifikojë çdo transaksion të debitimit direkt për të kontrolluar nëse shuma e transaksionit të debitimit direkt të dorëzuar është e barabartë me shumën dhe periodicitetin e rënë dakord në mandat përpara

debitimit të llogarisë së pagesave të paguesit, bazuar në informacionin e mandatit.

8. Ofruesit e shërbimeve të pagesave nuk do të kërkojnë që përdoruesit e shërbimeve të pagesave të tregojnë BIC-un e OSHP-së së një paguesi ose të OSHP-së së një përfituesi.

9. OSHP-ja e paguesit dhe OSHP-ja e përfituesit nuk do të vendosin tarifa shtesë ose tarifa të tjera në procesin e leximit të informacionit për të gjeneruar automatikisht një mandat për ato transaksione pagese të nisura nëpërmjet, ose me anë të një karte pagese në pikën e shitjes, të cilat rezultojnë në debitim direkt.

Neni 5
Sanksionet dhe ankimet

1. Për shkelje të dispozitave të kësaj rregulloreje, Banka e Shqipërisë vendos gjobat e përcaktuara në nenin 94, pika 2 të ligjit për shërbimin e pagesave.

2. Pikat 6 deri 15 të nenit 94, si dhe nenet 95, 96 dhe 97 të ligjit për shërbimet e pagesave janë të zbatueshme për çdo shkelje të dispozitave të kësaj rregulloreje.

Neni 6
Procedurat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve

Procedurat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve të përcaktuara në nenet 92 dhe 93 të ligjit për shërbimet e pagesave janë të zbatueshme për çdo mosmarrëveshje në lidhje me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo rregullore ndërmjet PSHP-ve dhe OSHP-ve të tyre.

Neni 7
Të fundit

Me qëllim aplikimin për pjesëmarrje të OSHP-ve në SEPA, Banka e Shqipërisë bashkëpunon dhe nxit OSHP-të që të marrin masat e nevojshme për përshtatjen e aktivitetit dhe funksionimin e tyre me kërkesat e kësaj rregulloreje brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve nga miratimi i zgjerimit të shtrirjes gjeografike të SEPA-s në Shqipëri, nga Këshilli Evropian i Pagesave.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të nenit 4, i cili hyn në fuqi pas miratimit të zgjerimit të shtrirjes gjeografike të SEPA-s në Shqipëri nga Këshilli Evropian i Pagesave.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Gent Sejko

SHTOJCA I
KËRKESAT TEKNIKE (NENI 4)

1. Përveç kërkesave thelbësore të përcaktuara në nenin 4, për transaksionet e transfertave të kreditit dhe të debitimit direkt, zbatohen kërkesat teknike të mëposhtme:

a) identifikuesi i llogarisë së pagesave të përmendur në nenin 4, pika 1, shkronjat "a" dhe "c", duhet të jetë IBAN;

b) standardi për formatin e mesazhit të përmendur në nenin 4, pika 1, shkronjat "b" dhe "d" duhet të jetë standardi ISO 20022 XML.

c) fusha e të dhënave të dërgesave duhet të lejojë 140 karaktere. Skemat e pagesave mund të lejojnë një numër më të madh karakteresh, përveçse në rastin kur pajisja e përdorur për dërgimin e informacionit ka kufizime teknike, në lidhje me numrin e karaktereve, ku në këtë rast zbatohet kufiri teknik i pajisjes;

d) informacioni i referencës së dërgesës dhe të gjitha elementet e tjera të të dhënave të ofruara në përputhje me pikat 2 dhe 3 të kësaj shtojce I, duhet të transmetohen plotësisht dhe pa ndryshime ndërmjet OSHP-ve në zinxhirin e pagesave;

e) pasi të dhënat e kërkuara të jenë të disponueshme në formë elektronike, transaksionet e pagesave duhet të lejojnë përpunimin plotësisht të automatizuar elektronik në të gjitha fazat e procesit në të gjithë zinxhirin e pagesave (nga fundi-në-fund, direkt nëpërmjet përpunimit), duke mundësuar kryerjen e të gjithë procesit të pagesës në mënyrë elektronike pa pasur nevojë për përdorimin përsëri të çelësave ose ndërhyrje manuale. Gjithashtu, kjo duhet të zbatohet për trajtimin e jashtëzakonshëm të transfertave të kreditit dhe transaksioneve të debitimit direkt, kurdo që është e mundur;

f) skemat e pagesave nuk duhet të vendosin asnjë kufi minimal për shumën e transaksionit të pagesës që lejon transfertat e kreditit dhe debitimet direkte, por nuk kërkohet të përpunojnë transaksionet e pagesave me vlerë zero;

g) skemat e pagesave nuk janë të detyruara të kryejnë transferta krediti dhe debitime direkte që tejkalojnë shumën prej 999 999 999,99 eurosh.

2. Përveç kërkesave të përmendura në pikën 1, për transaksionet e transfertave të kreditit zbatohen kërkesat e mëposhtme:

a) Elementet e të dhënave të përmendura në nenin 4, pika 3, shkronja "a", janë si më poshtë:

i. emri i paguesit dhe/ose IBAN-i i llogarisë së pagesës së paguesit;

ii. shuma e transfertës së kreditit;

iii. IBAN-i i llogarisë së pagesës së përfituesit;

iv. kur është e mundur, emri i përfituesit;

v. çdo informacion për dërgesën.

b) Elementet e të dhënave të përmendura në nenin 4, pika 3, shkronja "b", janë si më poshtë:

i. emri i paguesit;

ii. IBAN-i i llogarisë së pagesës së paguesit;

iii. shuma e transfertës së kreditit;

iv. IBAN-i i llogarisë së pagesës të përfituesit;

v. çdo informacion për dërgesën;

vi. çdo kod identifikimi i përfituesit;

vii. emri i çdo pale referencë të përfituesit;

viii. çdo qëllim i transfertës së kreditit;

ix. çdo kategori e qëllimit të transfertës së kreditit;

c) Përveç kësaj, elementet e mëposhtme të të dhënave të detyrueshme duhet t'i jepen OSHP-së së marrësit nga OSHP-ja e paguesit:

i. BIC-i i OSHP-së së paguesit (nëse nuk është rënë dakord ndryshe nga OSHP-të e përfshira në transaksionin e pagesës);

ii. BIC-i i OSHP-së së përfituesit (nëse nuk është rënë dakord ndryshe nga OSHP-të e përfshira në transaksionin e pagesës);

iii. kodi i identifikimit të skemës së pagesës;

iv. data e shlyerjes së transfertës së kreditit;

v. numri i referencës së mesazhit të transfertës të kreditit të OSHP-së së paguesit.

d) Elementet e të dhënave të përmendura në nenin 4, pika 3, shkronja "c", janë si më poshtë:

i. emri i paguesit;

ii. shuma e transfertës së kreditit;

iii. çdo informacion për dërgesën.

3. Përveç kërkesave të përmendura në pikën 1 të kësaj shtojce, për transaksionet e debitimit direkt zbatohen kërkesat e mëposhtme:

a) Elementet e të dhënave të përmendura në nenin 4, pika 4, shkronja "a", paragrafi (i), janë si më poshtë:

i. lloji i debitimit direkt (i përsëritur, i vetëm, i pari, i fundit ose në kah të kundërt);

ii. emri i përfituesit;

iii. IBAN-i i llogarisë së pagesës së përfituesit që do të kreditohet sipas kërkesës për arkëtim;

iv. kur është e mundur, emri i paguesit;

v. IBAN-i i llogarisë së pagesës së paguesit që do të debitohet sipas kërkesës për arkëtim;

vi. referenca unike e mandatit;

vii. data në të cilën është nënshkruar mandati i paguesit;

viii. shuma e kërkesës për arkëtim;

ix. kur mandati është marrë përsipër nga një përfitues tjetër i ndryshëm nga përfituesi që ka lëshuar mandatin, referenca unike e mandatit, siç është dhënë nga përfituesi fillestar që ka lëshuar mandatin;

x. identifikuesi i përfituesit;

xi. kur mandati është marrë përsipër nga një përfitues i ndryshëm nga përfituesi që ka lëshuar mandatin, identifikuesi i përfituesit fillestar që ka lëshuar mandatin;

xii. çdo informacion për transfertën, nga përfituesi tek paguesi;

xiii. çdo qëllim të kërkesës për arkëtim;

xiv. çdo kategori e qëllimit të kërkesës për arkëtim.

b) Elementet e të dhënave të përmendura në nenin 4, pika 4, shkronja "b", janë si më poshtë:

i. BIC-i i OSHP-së së përfituesit (nëse nuk është rënë dakord ndryshe nga OSHP-të e përfshira në transaksionin e pagesës);

ii. BIC-i i OSHP-së së paguesit (nëse nuk është rënë dakord ndryshe nga OSHP-të e përfshira në transaksionin e pagesës);

iii. emri i palës referencë të paguesit (nëse është i pranishëm në mandatin e dematerializuar);

iv. kodi i identifikimit të palës referencë të paguesit (nëse është i pranishëm në mandatin e dematerializuar);

v. emri i palës referencë të përfituesit (nëse është i pranishëm në mandatin e dematerializuar);

vi. kodi i identifikimit të palës referencë të përfituesit (nëse është i pranishëm në mandatin e dematerializuar);

vii. kodi i identifikimit të skemës së pagesës;

viii. data e shlyerjes së kërkesës për arkëtim;

ix. referenca e OSHP-së së përftuesit sipas kërkesës për arkëtim;

x. lloji i mandatit;

xi. lloji i debitimit direkt (i përsëritur, një herë, i parë, i fundit ose i kahut të kundërt);

xii. emri i përfituesit;

xiii. IBAN-i i llogarisë së pagesës së përfituesit që do të kreditohet sipas kërkesës për arkëtim;

xiv. aty ku është e mundur, emri i paguesit;

xv. IBAN-i i llogarisë së pagesës së paguesit që do të debitohet sipas kërkesës për arkëtim;

xvi. referenca unike e mandatit;

xvii. data e nënshkrimit të mandatit;

xviii. shuma e kërkesës për arkëtim;

xix. referenca unike e mandatit, siç është dhënë nga përfituesi fillestar që ka lëshuar mandatin (nëse mandati është marrë nga një përfitues i ndryshëm nga ai që ka lëshuar mandatin);

xx. identifikuesi i përfituesit;

xxi. identifikuesi i përfituesit fillestar që ka lëshuar mandatin (nëse mandati është marrë përsipër nga një përfitues i ndryshëm nga përfituesi që ka lëshuar mandatin);

xxii. çdo informacion për dërgesën, nga përfituesi tek paguesi.

c) Elementet e të dhënave të përmendura në nenin 4, pika 4, shkronja "c", janë, si më poshtë:

i. referenca unike e mandatit;

ii. identifikuesi i përfituesit;

iii. emri i përfituesit;

iv. shuma e arkëtimit;

v. çdo informacion për dërgesën;

vi. kodi i identifikimit të skemës së pagesës.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 6785, datë 15.12.2023, vendosi shpalljen si të vdekur të shtetasit Ervin Hasanaj i datëlindjes 10.11.1990 lindur në Krujë, me atësi Mehdi dhe me amësi Xhyhere, duke përcaktuar si datë vdekjeje datën 1.4.2015.

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2024/04/17 14:43:07 +02'00'
542490202404171442579103 1

Çmimi 160 lekë

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)